



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 440 Akti

Nr. 566 Vendimi
Tiranë, më 28.9.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bektashi	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Dajana Skura, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 23.9.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Edmond Shytko**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Edmond Shytko, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në mbledhjen e parë të trupit gjykues, në datën 23.12.2019, u caktua me mirëkuptim kryesuese komisionere Brunilda Bektoshi. Në respektim të legjislacionit në fuqi, mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatorja e çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Theo Jacobs. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit. Në datën 1.9.2022 subjekti u njoftua për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe rezultatet paraprake të këtij hetimi.

3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të pasurive;*
- *ka mosdeklarime ndër vite;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

6. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar.

¹Me shkresën nr. *** prot., datë 26.6.2019.

7. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

8. Në vijim janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

9. Trupi gjykues, i mbledhur në datën 1.9.2022, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi: përfundimin e hetimit kryesisht, duke u bazuar në tri kriteret e rivlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Edmond Shytko; njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet paraprake të hetimit administrativ në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

10. Z. Edmond Shytko, për një proces të rregullt ligjor, i janë garantuar të drejtat si: njoftimi për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërja e trupit gjykues; si dhe përfundimi kryesisht i hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës mbi rezultatet e hetimit. Në datën 1.9.2022 subjekti iu dërguan rezultatet paraprake të hetimit administrativ dhe iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

11. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e kryer elektronikisht në datën 21.9.2022. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 23.9.2022, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

13. Subjekti i rivlerësimit u paraqit në seancën dëgjimore dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit.

14. Në vijim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit nuk pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe, në përfundim, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Subjekti i rivlerësimit Edmond Shytko ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, z. Edmond Shytko ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

18. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, mundësinë për fshehje të pasurisë dhe në deklarimin e rremë apo konfliktin e interesit.

23. Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga z. Edmond Shytko në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në datën 26.1.2017 në ILDKPKI, ku subjekti ka deklaruar:

24. Apartament banimi, me sipërfaqe 64.8 m², ndodhur në Korçë, me vlerë të deklaruar 2.900 lekë. Subjekti ka deklaruar në pronësi të tij 4/7 e pasurisë, pjesa tjetër në bashkëpronësi me prindërit.

25. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se ASHK-ja Korçë² ka konfirmuar apartamentin me sip. 64.8 m², i ndodhur në Korçë, në pronësi të shtetasit Edmond Shytko. Nga aktet e depozituar nga ASHK-ja Korçë kanë rezultuar dy vendime për “Lëshimin e dëshmisë testamentare” të vitit 2018, hartuar nga noteri B. Z, sipas të cilave të dy prindërit e subjektit H dhe F.Sh, nëpërmjet testamenteve, i kanë lënë subjektit pjesët e tyre takuese të apartamentit. Pas çeljes së trashëgimisë testamentare i gjithë apartamenti ka kaluar në pronësi të subjektit.

Analiza e fakteve

26. Nga aktet e dosjes rezulton se ndërmjet ndërmarrjes Komunale Banesa Korçë dhe shtetasit H. Sh (babai i subjektit) është nënshkruar kontrata për privatizimin e banesës, në datën 18.8.1993, në shumën 2.900 lekë, sipas formularit nr. 3, për apartamentin nr. ***, me sip. 64.8 m², i ndodhur në rrugën “P.Xh”, Korçë.

Referuar akteve rezulton se kjo pasuri në momentin e privatizimit ka kaluar në bashkëpronësi të 6 bashkëpronarëve, përfshirë këtu edhe subjektin e rivlerësimit Edmond Shytko.

27. Në vijim, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 30.6.2003, subjekti i rivlerësimit ka blerë pjesët takuese të tre bashkëpronarëve të tjerë (dy vëllezërve dhe kunatës), të cilët zotëronin secili nga 1/7 pjesë që kishin në pronësi të apartamentit, në shumën totale prej 100.000 lekësh, të likuiduar jashtë zyrës noteriale. Pas blerjes, subjekti ka disponuar 4/7 pjesë të apartamentit.

28. Sipas deklarimeve në pyetësorin standard, subjekti banon në këtë apartament, i ndodhur në Korçë.

29. Në DPV-në e parë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar apartamentin në vlerën 1.500.000 lekë. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: *“Apartament banimi, fituar nga privatizimi i banesave në vitin 1993, në shumën 2.900 lekë. Zotëroj 4/7 pjesë, pasi 3/7 pjesë i kam fituar nga blerja e pjesëve të 2 vëllezërve dhe kunatës në shumën 100.000 lekë, në vitin 2003”*.

30. Në lidhje me vlerën e apartamentit prej 1.500.000 lekësh të deklaruar në DPV-në e vitit 2003, subjekti ka shpjeguar³ se: *“Gjatë periudhës 1992 – 2003, kur është bërë deklarimi i parë i pasurisë, vlera e apartamentit është rivlerësuar në bazë të ligjit, në shumën 1.500.000 lekë”*.

Nga verifikimi i akteve nuk rezulton që deri në vitin 2003 subjekti të ketë rivlerësuar këtë apartament.

31. Nga verifikimi i deklarimeve ka rezultuar mospërputhje në lidhje me vlerën e deklaruar të apartamentit, pasi në deklaratën *Vetting* është deklaruar vlera e privatizimit 2.900 lekë dhe shuma 100.000 lekë për blerjen e pjesëve takuese të vëllezërve, ndërsa në DPV-në e vitit 2003 është deklaruar vlera 1.500.000 lekë.

²Me shkresën nr. *** prot., datë 30.9.2020.

³Përgjigjet e pyetësorit ardhur me e-mail-in e datës 13.6.2022.

Mbi këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkua të japë shpjegime.

32. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje në lidhje me të ardhurat e ligjshme nga punësimi në detyrën e prokurorit, për periudhën 1993 – 2003, u analizua mundësia e subjektit për të përballuar shpenzimet për blerjen e pjesëve takuese të vëllezërve dhe kunatës në datën 30.6.2003, në shumën 100.000 lekë dhe për të përballuar shpenzimet jetike të familjes. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti dispononte burime të mjaftueshme financiare për të blerë pjesët takuese të bashkëpronarëve dhe për të përballuar shpenzimet sipas periudhës përkatëse.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

33. Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me mospërputhjet për vlerën e deklaruar të apartamentit, ka pretenduar se tashmë kanë kaluar 18 vjet dhe e ka të vështirë të shpjegojë qartë se përse është deklaruar një vlerë e tillë. Por, subjekti ka shpjeguar se mund të ketë pasur lidhje me një procedurë rivlerësimi të kësaj pasurie, për faktin se apartamenti ishte përfituar nëpërmjet privatizimit me vlerën 2.900 lekë dhe, për rrjedhojë, do të duhej të rivlerësohej me ndryshimin e vlerës së kohës, kur u bë deklarimi.

34. Subjekti ka shpjeguar se duke iu referuar Udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit K”, rezulton që për sipërfaqen e banimit të apartamentit 64.8, kostoja e apartamentit në këtë periudhë është vlerësuar në vlerën 1.579.759 lekë, e përafërt me vlerën 1.500.000 lekë të deklarua, pra, kjo do ketë qenë arsyeja e deklarimit të kësaj shume.

Vlerësimi i Komisionit

35. Komisioni vlerëson se në deklaratën *Vetting* është deklaruar saktë pasuria apartament banimi në përputhje me aktet e administruara. Subjekti ka deklaruar vlerën e privatizimit 2.900 lekë dhe shumën prej 100.000 lekësh të shpenzuar për blerjen e pjesëve takuese të vëllezërve. Subjekti ka provuar se apartamenti është fituar në mënyrë të ligjshme nëpërmjet privatizimit të banesave shtetërore. Në vijim ka blerë pjesët takuese nga bashkëpronarët, si dhe ka trashëguar pjesët takuese të prindërve. Të gjitha veprimet e subjektit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shpjegimet e tij në prapësime ishin të qarta dhe bindëse, pasi pasaktësia në lidhje me deklarimin e shumës 1.500.000 lekë në deklarimin e vitit 2003 lidhet me vlerën e pasurisë në momentin e deklarimit dhe, për pasojë, nuk mbartin ndikim negativ në vlerësimin përfundimtar.

36. Shtesë anësore, me sipërfaqe 34.8 m², ndërtim me leje në apartamentin sa më sipër, në shumën 307.983 lekë, me burim kursimet nga pagat

37. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se ASHK-ja Korçë⁴ ka konfirmuar shtesën anësore të ndërtuar në apartamentin e subjektit, si dhe informon se ka në pronësi një apartament me sip. 99.6 m², ku përfshihet edhe shtesa anësore.

Analiza e fakteve

38. Nga aktet e dosjes ka rezultuar se subjekti, për ndërtimin e kësaj shtese me sip. 34.8 m², është pajisur me leje ndërtimi të datës 19.9.2000, e cila është lëshuar për subjektin e rivlerësimit Edmond

⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 30.9.2020.

Shytko dhe dy shtetas të tjerë (banorë të pallatit ku ndodhet apartamenti) me objekt “shtesë pallati në rrugën ‘P.Xh’”.

39. Në lidhje me shtesën, subjekti ka depozituar aktet si vijon:

- vendim nr. **, datë 4.8.2000, i KRRT-së për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij, për z. Edmond Shytko dhe dy banorë të tjerë, me objekt “shtesë pallati 3 kate, me sipërfaqe sheshi dhe ndërtimi 34.8 m²”;
- hartë treguese, relacion mbi ndërtimin, si dhe procesverbal i kolaudimit i datës 1.9.2000, me objekt shtesën e pallatit të cituar më sipër;
- situacion i punimeve për shtesën, i kryer në rrugën “P.Xh”, Korçë, me pronarë z. Edmond Shytko dhe dy banorë të tjerë. Për shtesën anësore me sip. 34.8 m² të ndërtuar në 3 kate (nga të cilat njëri kat është i subjektit) është shpenzuar në total shuma prej 935.220 lekësh, ku z. Edmond Shytko ka paguar për pjesën takuese në vlerën 299.964 lekë.

40. Bashkëpronarët e shtesës anësore, me kontratën nr. ***, datë 26.9.2001, kanë blerë truallin në shumën 25.056 lekë, me palë shitëse Bashkia Korçë. Pas ndërtimit është vijuar me regjistrimin e shtesës anësore pranë ZVRPP-së Korçë.

41. Në lidhje me burimin e krijimit të shtesës anësore, subjekti ka deklaruar:

- në deklaratën *Vetting*, kursimet nga pagat;
- në përgjigje të pyetësorit ka deklaruar⁵ si burim “kursimet e pagave që nga viti 1994 dhe në vazhdim”;
- në DPV-në e vitit 2003 ka deklaruar si burim për ndërtimin e shtesës të ardhurat nga pagat dhe ndihma e bashkëpronarëve, duke mos saktësuar ndihmën apo kontributin e bashkëpronarëve.

Në lidhje me mospërputhjen për burimin e krijimit të shtesës, subjektit iu kalua barra e provës.

Analiza financiare për ndërtimin e shtesës

42. Komisioni kreu analizën financiare për të vlerësuar mundësitë e subjektit për të kryer ndërtimin e shtesës në vitin 2000, si dhe përballimin e shpenzimeve. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti kishte burime të mjaftueshme financiare për ndërtimin e shtesës dhe blerjen e truallit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

43. Në lidhje me konstatimin e Komisionit për mospërputhje të deklarimeve të subjektit për burimin e krijimit të shtesës, ku është deklaruar se *burimi i krijimit të shtesës është krijuar me kursimet dhe ndihma e bashkëpronarëve*, subjekti me “ndihmën e bashkëpronarëve” ka nënkuptuar bashkëpronarët e truallit ku është bërë kjo shtesë anësore me sip. 34.8 m².

44. Subjekti dha shpjegime duke saktësuar se trualli ku është ndërtuar kjo shtesë pallati me sip. 34.8 m² është në bashkëpronësi të tre banorëve që kanë marrë pjesë në ndërtimin e saj. Ky truall është shitur nga Bashkia Korçë tek blerësit Edmond Shytko dhe shtetasit I. Z. dhe R. M., si bashkëpronarë/banorë të pallatit, në shumën 25.056 lekë, sipas kontratës së shitblerjes datë 26.9.2001. Shuma 25.056 lekë e blerjes së truallit me sip. 34.8 m² është paguar nga të tre bashkëpronarët e këtij trualli në 1/3 e vlerës.

⁵Në përgjigjet e pyetësorit të ardhur me *e-mail*-in e datës 13.6.2022.

45. Subjekti ka shpjeguar se, sikurse ka konstatuar edhe Komisioni, për ndërtimin e shtesës ka pasur mjaftueshëm burime financiare për ta përbërë ndërtimin e saj, totalisht me të ardhurat e tij të ligjshme. Referimi që subjekti i ka bërë ndihmës së bashkëpronarëve, duke qenë se janë bashkëpronarë në këtë ndërtim të kryer, është për pjesën e tyre takuese të ndërtimit.

Vlerësimi i Komisionit

46. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit janë të pranueshme dhe bindëse, në vlerësim të faktit se nga analiza financiare e kryer ka rezultuar se subjekti ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për ndërtimin e shtesës.

47. Garazh me sipërfaqe 24.5 m², ndodhur në Korçë, blerë në shumën 400.000 lekë, në pronësi të subjektit, krijuar me kursimet nga pagat

48. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se ASHK-ja⁶ ka konfirmuar pasurinë garazh, me sip. 24.5 m², në pronësi të z. Edmond Shytko.

49. Nga aktet e dosjes rezulton se me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 30.4.2002, pala blerëse Edmond Shytko ka blerë nga shoqëria “K ***” sh.p.k., garazhin nr. *, në shumën 400.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

50. Lidhur me burimi e krijimit, subjekti ka shpjeguar⁷ se: *“Si burim për blerjen e garazhit në vitin 2003, në shumën 400.000 lekë janë kursimet e mia dhe të bashkëshortes nga pagat e marra për periudhën 1994 – 2003”*.

51. Analiza financiare për blerjen e garazhit u krye bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, duke analizuar të ardhurat, shpenzimet dhe investimet e familjes së subjektit për periudhën 1994 – 2003. Referuar analizës së përgjithshme financiare⁸ rezultoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme për blerjen e garazhit dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera, duke rezultuar me balancë pozitive.

Vlerësimi i Komisionit

52. Bazuar në provat e administruara, subjekti ka deklaruar saktë pasurinë garazh dhe ka provuar burimet e ligjshme për krijimin e tij, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

53. Apartament me sipërfaqe 54.5 m², ndodhur në Pogradec, në vlerën 2.500.000 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten, pasuri e fituar me dhurim

54. ILDKPKI-ja ka konstatuar mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të shumës 2.500.000 lekë për blerjen në vitin 2007 të apartamentit me sip. 54.5 m² nga shtetasi M. Gj(kunati i subjektit).

Nga hetimit i Komisionit ka rezultuar:

55. Drejtoria Vendore ASHK Pogradec⁹ ka konfirmuar se shtetasit Edmond dhe J.Sh kanë në pronësi pasurinë apartament me sip. 54.5 m², i ndodhur në Pogradec.

⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 30.9.2020.

⁷Në përgjigjet e pyetësorit të ardhur me e-mail-in e datës 13.6.2022.

⁸Shihni analizën financiare në fund të kriterit të pasurisë.

⁹Drejtuar ILDKPKI-së me përgjigjen elektronike përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 26.6.2019.

56. FSHU-ja¹⁰ ka informuar se referuar të dhënave të sistemit të faturimit në emër të shtetasit Edmond Shytko rezulton një abonent me kontratë furnizimi për energjinë elektrike në instancën e Pogradecit.

57. FSHU-ja¹¹ ka informuar se referuar të dhënave të sistemit të faturimit rezulton se kontrata nr. A-***, e hapur në datën 1.7.2006, aktualisht i përket abonentit Edmond Shytko, duke bashkëlidhur faturën e parë në emër të subjektit, që daton në nëntor të vitit 2009. Bashkëlidhur përgjigjes së FSHU-së rezulton një faturë tatimore (kopje elektronike), lëshuar në emër të z. Edmond Shytko, e datës 19.11.2009.

58. UKP-ja¹² ka bashkëlidhur kontratën e lidhur fillimisht nga shtetasi M.Gj dhe kërkesën e tij drejtuar UKP-së, për lidhjen e kontratës të datës 21.12.2007.

Hetimi i Komisionit dhe analiza e fakteve

59. Nga aktet e dosjes rezulton se apartamenti i ndodhur në Pogradec është blerë nga shtetasi M. Gj, me palë shitëse shtetasin F.H, me kontratën nr. ***, datë 9.1.2007, në shumën 2.500.000 lekë, e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Pasuria është regjistruar në emër të blerësit, sipas certifikatës së pronësisë, në datën 26.1.2007.

60. Në vijim, shtetasi M.Gj, me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 19.1.2009, ia dhuron apartamentin motrës dhe bashkëshortit Edmond Shytko, në shenjë mirënjohjeje dhe respekti për të gjithë kujdesin ndaj nënës dhe ndihmën e tyre të dhënë deri në atë moment, në mungesë të tij. Në vijim, kjo pasuri është regjistruar në emër të tyre, referuar certifikatës për vërtetim pronësie në datën 21.1.2009.

61. ASHK-ja, drejtoritë vendore, nuk kanë konfirmuar pasuri të tjera të paluajtshme të regjistruara në emër të dhuruesit M.Gj.

62. UKT-ja¹³ ka informuar se nuk rezultojnë të dhëna për ndonjë kontratë për shërbime ujësjellësi në Tiranë.

63. UKP-ja¹⁴ ka informuar se shtetasi M.Gj ka lidhur për herë të parë kontratën për furnizim pranë ujësjellës-kanalizime Pogradec, për apartamentin e ndodhur në rrugën “** D e P”, Pogradec, në datën 21.12.2007.

64. QKB-ja¹⁵ ka informuar se për shtetasin M.Gj nuk rezultojnë të dhëna për regjistrime pranë këtij institucioni, si dhe nuk rezulton i pajisur me licencë/leje.

65. DPSHTRR-ja¹⁶ ka informuar se shtetasi M.Gj nuk ka automjete të regjistruara në këtë institucion.

66. Sistemi AMF¹⁷, faqja zyrtare, nuk referon të dhëna për blerje të policave të sigurimit për shtetasin M.F.Gj, i datëlindjes 31.8.1979.

¹⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 23.7.2020.

¹¹Me shkresën nr. *** prot., datë 1.2.2022.

¹²Me shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2022.

¹³Me shkresën nr. k-*** prot., datë 30.7.2020.

¹⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2022.

¹⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 24.7.2020.

¹⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2020.

¹⁷AMF, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

67. DRT-ja Korçë¹⁸ ka informuar se nuk disponon të dhëna për shtetasin M.Gj.

68. ISSH-ja¹⁹ ka informuar se disponon të dhëna nga vitit 2012 e në vijim. Pra, për periudhën e kërkuar nga Komisioni nuk disponohen të dhëna nga ky institucion.

69. Komisioni ka kërkuar informacion të plotë bankar pranë të gjitha bankave të nivelit të dytë në Shqipëri. Nga të dhënat bankare deri në datën 9.1.2007, kur është blerë apartamenti në Pogradec nga shtetasi M.Gj, rezulton se ky shtetas ka llogari në euro dhe lekë pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, ku janë kryer disa transaksione gjatë periudhës 2003 – 2004 (tri transfertat në vitin 2003 në shumën totale 265.672 lekë dhe depozitime *cash* në shuma të vogla, në total 121.652 lekë dhe 1.950 euro).

70. Nga hetimi i Komisionit në lidhje me dhuruesin e apartamentit M.Gj rezultoi se ky shtetas nuk ka kryer investime në pasuri të paluajtshme, automjete, depozita apo çdo investim tjetër. Në këtë situatë, për Komisionin rezultoi e dyshimtë dhe e paqartë arsyeja e dhurimit të apartamentit subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes.

71. Komisioni, në përputhje me nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, i ka kërkuar subjektit të provojë me dokumentacion ligjshmërinë e burimit të krijimit për dhuruesin (kunatin), pra burimet e ligjshme të tij për blerjen e apartamentit në Pogradec, në datën 9.1.2007.

72. Subjekti ka shpjeguar se: *“Kunati M.Gj ka studiuar në Turqi dhe pas mbarimit të shkollës së lartë është kthyer në Shqipëri. Gjatë periudhës së qëndrimit në Shqipëri ka punuar, sa vijon:*

- *shtator 2002 – maj 2003, ‘Assistant to the S.R of the S.G (***) of the C of E in T, Albania’;*
- *korrik 2003 – mars 2004, ‘P.R& R.M.A’, program i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (U. N.D.P. C.O,A), Tiranë, Shqipëri;*
- *2004 – 2005, konsulenca të ndryshme me ‘Albanian L.I’;*
- *maj 2004 – shkurt 2005, konsulent, B.B(The W.B. Country Office, Albania), Tiranë, Shqipëri;*
- *prill 2005 – dhjetor 2006, Drejtor Marketingu, T.M.G (T.C. TV, T.A.R, D.T and Satellite TV), Tiranë, Shqipëri;*
- *prill – dhjetor 2006, Drejtor Marketingu, T.M.G(T.C.TV, T.A.R, Tiranë;*
- *janar 2007 – gusht 2008, koordinator për fushatat ndërgjegjësuese dhe partneritet të ‘S to S. S.R(***)’ të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (U.N.D.P.C office Albania), Tiranë, Shqipëri.*

Për sa më sipër, provohet me mesazhin e dërguar nga M.Gj në datën 22.12.2021, të cilën po ju a vë në dispozicion, ku sqaron të ardhurat e tij të fituara nga puna për periudhën para blerjes së apartamentit në Pogradec.

Kontratat e punësimit nuk i disponon, pasi një pjesë e madhe e tyre në atë kohë, 15 - 20 vite më parë, kanë qenë në formate të ndryshme, në disa raste pa kopje për punëmarrësin ose të depozituara pranë punëdhënësit. Gjithashtu, pagesat në rastin e sektorit privat nuk bëheshin në bankë, por në arkën e shoqërisë, si në rastin e ‘T.M.G’...”.

Konstatime të Komisionit

73. Në lidhje me apartamentin në Pogradec u konstatua se:

¹⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2020.

¹⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2020.

- Subjekti nuk provoi të ardhurat e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie nga ana e dhuruesit në shumën 2.500.000 lekë, në vitin 2007.
- Duket e paqartë arsyeja e dhurimit të pasurisë së vetme të dhuruesit familjes së subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

74. Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme të dhuruesit të apartamentit M.Gj, sikurse edhe gjatë hetimit, subjekti ka paraqitur të njëjtat pretendime, si vijon:

- Është fakt i konfirmuar se dhuruesi M.Gj ka pasur një punësim të ligjshëm dhe në vazhdimësi në institucionet ndërkombëtare si: B.B, K e B, etj., si në Shqipëri, edhe aktualisht në Zvicër.
- Dhuruesi nuk i disponon kontratat e punësimit në këto institucione, pasi një pjesë e madhe e tyre në atë kohë, 15 - 20 vite më parë, kanë qenë në formate të ndryshme, në disa raste pa kopje për punëmarrësin ose të depozituara pranë punëdhënësit, por subjekti ka provuar punësimin e tij në këto institucione.
- Në lidhje me punësimin e dhuruesit M.Gj në Shqipëri pranë "T.M.G", nuk ka disponuar kopje të kontratës si punëmarrës, si dhe, sikurse është operuar për shumë kohë nga subjektet tregtare private, pagesat e rrogës në rastin e sektorit privat nuk bëheshin në bankë por në arkën e shoqërisë.

75. Subjekti ka depozituar disa prova të reja për të provuar punësimin e dhuruesit/kunatit të tij në institucionet ndërkombëtare, sipas përshkrimeve:

a. Programi i K të B për Zhvillim (***), lëshuar në datën 18.7.2022, ku vërtetohet se z. M.Gj ka qenë i punësuar në këtë institucion në Shqipëri në periudhat, si më poshtë vijon:

- 1.8. 2003 – 31.10.2003 në kontratën ***, si asistent koordinator rajonal për zyrën e ***në Tiranë;
- 15.6.2007 – 14.9.2007, nën marrëveshjen e Shërbimeve Sociale, si asistent i ndërgjegjësimit publik ose informacionit për projektin ***/***;
- 10.3.2008 – 23.3.2008, nën marrëveshjen e Shërbimeve Sociale, si interpretues për projektin ***;
- 14.4.2008 – 4.5.2008, nën marrëveshjen e Shërbimeve Sociale, si konsulent i informacionit publik për projektin ***/***;

b. Dokument nga B.B, me datë lëshimi 2.3.2022, z. M.Gj ka qenë i punësuar në datat e emërimit 4.5.2004 dhe emërimi më i fundit 12.3.2004 – 15.1.2005.

c. Dokument nga K i E, me datë 31.12.2002, z. M.Gj ka qenë i punësuar për periudhat:

- 25.11.2002 – 31.12.2002, kohë e plotë, me pagë mujore *bruto* 530 USD;
- 1.1.2003 – 1.3.2003, kohë e plotë, me pagë mujore *bruto* 530 USD;
- 1.4.2003 – 14.4.2003, kohë e plotë, me pagë mujore *bruto* 530 USD;
- 2.3.2003 – 31.3.2003, kohë e plotë, me pagë mujore *bruto* 530 USD.

76. Mbështetur në provat sa më sipër, subjekti ka pretenduar të provojë faktin që kunati M.Gj, gjatë periudhës pas mbarimit të shkollës, ka punuar në mënyrë të ligjshme në Shqipëri. Subjekti

shpjegon se ecuria e punës së personit të lidhur/kunatit në institucionet ndërkombëtare ka qenë në mënyrë vazhduese pranë këtyre institucioneve, fakt që tregon se deklaratimet e shtetasit M.Gj, të përshkruara më sipër, janë të besueshme dhe duhet të pranohen nga Komisioni.

77. Subjekti ka shpjeguar se gjatë punësimit të shtetasit M.Gj në periudhën prilli 2005 – dhjetor 2006, si Drejtor Marketingu në T.M.G, paga mujore ka qenë 120.000 deri në 150.000 lekë, por nuk ka disponuar dokumentacion.

Subjekti, në mbështetje të pretendimeve të tij, ka shpjeguar se i është drejtuar zyrtarisht televizionit kombëtar “T.C” për të marrë konfirmim e punës për kunatin, por deri në datën e depozitimit të prapësimeve nuk ka mundur të marrë përgjigje prej tyre.

78. Subjekti ka pretenduar se Komisioni, në vlerësim të saktë të situatës dhe në mënyrë objektive, duhet të marrë në konsideratë faktet vijuese:

- pamundësinë e “personit tjetër të lidhur”, për dhuruesin M,Gj, për të siguruar dokumentacion provues si kontratat e punësimit dhe dokumente të tjera provuese sepse kjo pamundësi ka ardhur për arsye objektive, pasi janë dokumente të hartuara para rreth 20 vjetësh dhe, si të tilla, nuk mund të gjenden;
- ka kaluar një kohë e gjatë që nga periudha e punësimit të shtetasi M,Gj në Shqipëri dhe vështirësohet gjetja e dokumentacionit, pasi të dhënat janë të arkivuara kryesisht për punëdhënësit e tij me seli jashtë vendit, por është evidente që kunati M,Gj ka pasur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme për apartamentin në Pogradec;
- periudha e punësimit të shtetasit M.Gj, që kërkohet të provohet me dokumentacion, i takon një periudhe ku në vendin tonë ka pasur informalitet të lartë, për pasojë, nuk mund të penalizohen punonjësit për shkak të informalitetit të palëve të treta të pa përfshirë në këtë proces, por që kanë qenë punëdhënës të “personit tjetër të lidhur” në rastin konkret.

79. Në lidhje me arsyen e dhurimit të apartamentit, subjekti ka shpjeguar se *apartamenti është dhuruar nga kunati (vëllai i bashkëshortes) motrës së tij dhe subjektit, si mirënjohje për të gjithë kontributin dhe përkujdesin që kanë treguar për të, pasi e ndjera, nëna e dhuruesit dhe e bashkëshortes së subjektit, është ndarë nga jeta në vitin 1988.*

80. Bashkëshortja e subjektit, si motra e madhe, është përkujdesur për të vëllanë M.Gj në mënyrë të vazhdueshme që në shkollimin e tij në shkollën e mesme “T. O” për periudhën 1994 – 2002, derisa ky i fundit ka mbaruar shkollën e lartë në Stamboll, Turqisë. Ndihma ka qenë e pakushtëzuar, pa kompensim apo pritshmëri prej tij.

Vlerësimi i Komisionit

81. Komisioni, pasi administroi të gjitha aktet e depozituar nga subjekti, shqyrtoi dhe analizoi të gjitha provat dhe shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, në vlerësim të të gjitha provave dhe fakteve të rezultuara nga hetimi, ka arritur në konkluzionin se:

- Subjekti arriti të provojë që kunati i tij ka qenë i punësuar në mënyrë të ligjshme (me kohë të pjesshme) pranë B.B dhe *** dhe të ardhurat e ligjshme të përfituara nga ky punësim, të provuar me dokumentacion, janë në shumën 2.385 USD.
- Subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion punësimin e kunatit në “T.M.G dhe as të ardhurat e ligjshme të përfituara nga ky punësim për periudhën prill 2005 – dhjetor 2006.

- Në përmbushje të detyrimit ligjor, bazuar në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, subjekti nuk mundi të provojë burimet e ligjshme të kunatit për blerjen e apartamentit në Pogradec, në shumën 2.500.000 lekë.

82. Në lidhje me pretendimin e subjektit që ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar të ardhurat e ligjshme të kunatit, pasi ka kaluar një kohë shumë e gjatë, rreth 20 vjet, dhe dokumentacioni është përtej afateve të ruajtjes në arkiva në rastet e institucioneve të huaja, Komisioni vlerëson që ky pretendim i subjektit nuk mund të pranohet, pasi:

- Subjekti arriti pjesërisht të depozitonte dokumentacion provues mbi punësimet e kunatit, pra rezultoi që këto institucione i kanë vënë në dispozicion personit të interesuar aktet edhe ndonëse dokumentet ishin arkivuar kohë më parë.

83. Në rastin e të ardhurave të përfituar nga punësimi i shtetasit M.Gj pranë “T.M.G”, subjekti nuk arriti të provojë punësimin e tij në këtë institucion, e aq më pak pamundësinë objektive të këtij institucioni për të disponuar këto akte dhe arsyet e mosdisponimit të tyre mbi punësimin e këtij shtetasi dhe të ardhurat e përfituara nga ky punësim, në përputhje me detyrimin ligjor të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

84. Në lidhje me shkakun e dhurimit të apartamentit nga kunati te subjekti dhe bashkëshortja e tij, për Komisionin mbetet e pa qartë arsyeja e dhurimit të apartamentit në pronësi të kunatit. Kjo paqartësi mbështetet në faktet se:

- Shtetasi M.Gj nuk dispononte asnjë pasuri tjetër të paluajshme apo të luajshme në Shqipëri, si automjet, depozita, bono thesari, etj.
- Gjatë punësimit të shtetasit M.Gj në Tiranë, ai ka banuar në qytetin e Mamurrasit²⁰, ndërkohë që blen një apartament në Pogradec, qytet në të cilin nuk e lidhte asgjë, përveç afërsisë me Korçën ku banonte e motra bashkë me subjektin e rivlerësimit.
- Nga hetimi i Komisionit rezultoi se shtetasi M.Gj nuk dispononte burime të mjaftueshme financiare për të blerë apartamentin në Pogradec, në shumën 2.500.000 lekë.

85. Në analizim të të gjithë situatës, Komisioni ka vlerësuar gjithashtu edhe mundësinë e blerjes së këtij apartamenti nga ana e subjektit në vitin 2007. Nga analiza financiare e përgjithshme e kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk dispononte të ardhura të mjaftueshme financiare për të blerë apartamentin në vitin 2007, në shumën 2.500.000 lekë.

86. Nisur nga fakti i mungesës së dokumentacionit ligjor për të provuar të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, dhuruesit, që kishin shërbyer për blerjen e apartamentit në Pogradec në vitin 2007, fakt ky penalizues për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, u konkludua se subjekti nuk provoi bindshëm burimet e ligjshme të dhuruesit për krijimin e pasurisë apartament në Pogradec, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

87. Apartament banimi në Tiranë, me sipërfaqe 91.88 m², blerë në shumën 8.450.000 lekë

²⁰Sipas deklarimeve të subjektit në seancën dëgjimore të datës 23.9.2022.

88. Si burim krijimi janë deklaruar: (i) kursime në shumën 2.921.954 lekë të mbledhura ndër vite; (ii) hua pa interes në shumat 25.000 USD dhe 5.700 euro²¹, marrë kunatit M.Gj; (iii) hua pa interes në shumën 15.000 euro, marrë vëllait L.Sh.

Hetimi i Komisionit

89. ASHK-ja Tiranë Jug²² ka konfirmuar se shtetasit E.Sh dhe J.Sh kanë në pronësi pasurinë apartament me sip. 91.88 m², me nr. ***, ndodhur në Tiranë. Nga aktet e dosjes rezulton se subjekti, me kontratën nr. ***, datë 5.7.2012, ka blerë apartamentin me sip. 91.88 m², i ndodhur në Rr e K, Tiranë, në shumën 8.450.000 lekë, nga shitësi A.L. Ky i fundit ia ka blerë shoqërisë së ndërtimit “M-c” sh.p.k., në datën 29.12.2011, në shumën 8.045.440 lekë. Shuma është likuiduar tërësisht nëpërmjet transfertës bankare në “Credins Bank”, sipas mandatpagesës së datës 5.7.2012, në shumën 8.450.000 lekë, e konvertuar në 61.100 euro. Subjekti e ka regjistruar apartamentit në emër të tij dhe të bashkëshortes, sipas vërtetimit hipotekor të datës 27.7.2012.

90. Komisioni i kërkoi subjektit të saktësojë pozicionimin e apartamentit në hartë. Subjekti ka depozituar²³ foto të vendndodhjes së pallatit të ndodhur në Rr e K, ku sipas saj duket se çmimi i referencës sipas EKB-së për zonën (***) ku ndodhet pasuria është 91.900 lekë/m². Subjekti e ka blerë apartamentin me çmim 91.967 lekë/m².

✓ Sa më sipër, nuk duket se ka ndonjë trajtim preferencial për blerjen e apartamentit.

91. Subjekti, në deklaratën *Vetting*, si dhe në DPV-në e vitit 2012, ka deklaruar të njëjtin burim krijimi për apartamentin, si vijon:

- i. kursime në shumën 2.921.954 lekë të mbledhura në vite,
- ii. hua pa interes në shumën 15.000 euro, marrë tek vëllai L.Sh.
- iii. hua pa interes në shumat 25.000 USD dhe 5.700 euro²⁴, marrë kunatit M.Gj.

Hetimi i Komisionit mbi burimet për blerjen e apartamentit në Tiranë

i. Komisioni analizoi krijimin e kursimeve në shumën 2.921.954 lekë.

92. Në lidhje me burimin e deklaruar si kursime të mbledhura ndër vite në shumën 2.921.954 lekë, rezulton se subjekti, në DPV-në e vitit 2012, në kapitullin “Ndryshime të pasurive të paluajtshme”, ka deklaruar *blerjen e shtëpisë në shumën 8.450.000 lekë*. Në të njëjtën faqe ka deklaruar *pakësim gjatë vitit 2012 të shumës në gjendje cash nga viti 2005 deri në vitin 2012, në shumën 2.200.000 lekë*.

93. Nga verifikimi i DPV-ve periodike duket se subjekti ka deklaruar saktë shumat *cash* dhe se përputhen me deklaratimet në DPV dhe në deklaratën *Vetting* të përdorimit të kursimeve *cash* dhe në bankë. Gjithashtu, ka rezultuar se në vitin 2012 subjekti ka pakësuar edhe depozitën në shumën 400.000 lekë në emër të bashkëshortes në BKT.

94. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni mbi mundësitë e subjektit për krijimin e kursimeve në shumën 2.921.954 lekë, për periudhën 2005 – 2012, të cilat janë deklaruar se janë

²¹Kursi i këmbimit në atë kohë 1 euro = 138.3 lekë; 1 USD = 110 lekë; 1 euro = 1.26 USD.

²²Me shkresën nr. *** prot., datë 11.9.2020.

²³Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 22.7.2022.

²⁴Kursi i këmbimit në atë kohë 1 euro = 138.3 lekë; 1 USD = 110 lekë; 1 euro = 1.26 USD.

përdorur për blerjen e apartamentit, subjekti rezultoi me një balancë negative për të krijuar likuiditetet dhe përballuar shpenzimet në shumën totale prej 678.111 lekësh.

Hetimi i Komisionit mbi burimet e ligjshme të huadhënësve

Huadhënësi M.Gj, kunati i subjektit

ii. Si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë është deklaruar hua në shumat 25.000 USD dhe 5.700 euro.

95. Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se huadhënësi nuk kishte pasuri të paluajtshme të regjistruara, automjete apo të dhëna punësimi të regjistruara në Shqipëri, sipas hetimit të kryer, trajtuar në pikën 45.

96. Subjekti, ka shpjeguar se²⁵ shtetasi M.Gj nuk disponon pasuri të paluajtshme brenda apo jashtë vendit, por disponon llogari bankare, duke depozituar të dhëna bankare të tij pranë Komisionit.

97. Nga të dhënat bankare rezulton një nxjerrje llogarie në USD, datë 27.6.2012, nga “Intesa Sanpaolo Bank” në emër të shtetases J.Sh. Referuar këtij dokumenti rezultoi e provuar se bashkëshortja e subjektit ka marrë në llogarinë e saj bankare shumat 25.000 USD dhe 5.000 euro nga i vëllai M.Gj. Kjo shumë është marrë përpara datës së nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së apartamentit, 5.7.2012, ditë në të cilën është bërë edhe pagesa e plotë në llogarinë bankare të shitësit sipas mandatpagesës të “Credins Bank”, datë 5.7.2012, në shumën 8.450.000 lekë, konvertuar në shumën 61.100 euro.

98. Në lidhje me burimet e ligjshme të huadhënësit M.Gj, subjektit i është kërkuar të provojë burimet e ligjshme të të ardhurave të huadhënësit.

99. Subjekti ka shpjeguar²⁶ se: *“Në lidhje me shumat 25.000 USD dhe 5.700 euro hua nga kunati M.Gj për blerjen në vitin 2012 të apartamentit në Tiranë, ju bëjmë me dije se M.Gj në përbërjen e tij familjare kanë qenë tre veta, babai dhe motra e tij. M.Gj nga viti 2009 e në vazhdim ka jetuar jashtë vendit i vetëm, për shkak të punësimit të tij në mënyrë të ligjshme.”*

100. Subjekti ka depozituar një certifikatë familjare të shtetasit M. Gj, i cili në datën 20.1.2017 rezulton në certifikatë familjare me babain e tij.

101. Për të provuar burimet e ligjshme të huadhënësit, subjekti ka depozituar:

- kontratë punësimi të shtetasit M.Gj me punëdhënësin ***, me datë fillimi 23.5.2021;
- letër emërimi datë 11.6.2012, të shtetasit M.Gj, me ***;
- vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë 27.12.2021, sipas të cilit janë përkthyer nga gjuha angleze 6 kontrata konsulence për shtetasin M.Gj, për periudhën 2009 – 2012;
- nxjerrje të llogarisë bankare të shtetasit M.G në datën 15.6.2021, me balancë 247.078 euro.

102. Subjekti ka shpjeguar se kunati M.Gj është i punësuar si konsulent pranë “U.N”. Të ardhurat e përfituara në këtë institucion janë të përjashtuara nga detyrimet tatimore, bazuar kjo në ligjin nr. 9105, datë 17.7.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për privilegjet dhe imunitetet e agjencive të specializuara”, seksioni 19, pika “b”, ku parashikohet se: *“Zyrtarët e agjencive të specializuara: b. Do të gëzojnë të njëjtat përjashtime nga taksimi në lidhje me rrogat*

²⁵Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 22.7.2022.

²⁶Në përgjigjet e pyetësorit të ardhur me e-mail-in e datës 27.12.2021.

dhe pagesat që u bëhen atyre nga agjencitë e specializuara dhe me të njëjtat kushte që gëzohen nga zyrtarët e Kombeve të Bashkuara”. Në zbatim të këtij ligji, të ardhurat e shtetasit M.Gj nuk janë të takueshme, për shkak të aderimit të Shqipërisë në këtë konventë dhe, për pasojë, janë të ardhura të ligjshme.

103. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti, në lidhje me burimin e ligjshëm të shtetasit M.Gj, duket se vetëm për një kontratë punësimi janë parashikuar pagesat *bruto* dhe *neto* pas pagimit të taksave. Për kontratat e tjera të depozituara janë parashikuar të ardhura *bruto*, si vijon:

- të ardhurat *bruto* për periudhën gusht 2009 – qershor 2012 kanë rezultuar në shumën 207.111 USD;
- të ardhurat *neto* (sipas kontratës) kanë rezultuar në shumën 9.572 USD;
- shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas të dhënave zyrtare të Eurostat për shtetin e Zvicrës, ku edhe ka jetuar huadhënësi.

104. Nga dokumentacioni bankar është evidentuar një llogari në dollarë amerikanë, e çelur nga shtetasi M.Gj pranë “Intesa Sanpaolo Bank”. Nga kjo llogari në datën 21.6.2012 është transferuar shuma 25.000 USD për shtetasen J.Sh (shuma e përdorur prej familjes së subjektit për blerjen e apartamentit).

105. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare në llogaritë e shtetasit M.Gj janë kredituar shuma të ndryshme në USD, në dukje nga jashtë vendit, përgjatë viteve 2010, 2011 dhe 2012, si më poshtë vijon:

Vlerësimi i Komisionit për huadhënësin M.Gj

106. Mbi mundësitë financiare të huadhënësit M.Gj për dhënien e huas – nga analizimi i të dhënave të dokumentuara rezultoi se huadhënësi ka pasur të ardhura të ligjshme nga punësime dhe likuiditete në bankë në shuma të konsiderueshme, të mjaftueshme për të dhënë huan në shumat 25.000 USD dhe 5.700 euro në vitin 2012, në përputhje me nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

Huadhënësit L dhe M.Sh

iii. Si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë është deklaruar huaja në shumën 15.000 euro.

Hetimi i Komisionit dhe analiza e fakteve

107. ASHK-ja Korçë²⁷ ka informuar se në emër të shtetasit L.Sh rezulton e regjistruar pasuria e llojit “apartament” me sip. 80 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. **, f. ***, blerë në datën 28.4.2004, në shumën 1.900.000 lekë.

QKB-ja²⁸ ka informuar se shtetasi L.Sh nuk rezulton të jetë regjistruar pranë QKB-së për ushtrim të ndonjë aktiviteti, si dhe nuk rezulton të jetë pajisur me licencë/leje.

DPSHTRR-ja²⁹ ka informuar se shtetasi L.Sh nuk ka automjete të regjistruara në DPSHTRR.

AMF, faqja zyrtare, nuk referon të dhëna për blerje të policave të sigurimit për shtetasin L.Sh.

²⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 30.9.2020.

²⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 24.7.2020.

²⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2020.

DRT-ja Korçë³⁰ ka referuar se nuk disponon të dhëna për shtetasin L.Sh.

ISSH-ja³¹, për periudhën nga viti 2012 e në vijim, nuk ka referuar të dhëna për shtetasin L.Sh.

108. Në lidhje me huan dhënë bashkëshortes së subjektit J.Sh, nga aktet e dosjes rezultoi se shtetasit L dhe M.Sh³² (vëllai dhe kunata e subjektit) kanë emëruar si përfaqësuese shtetasen J.Sh (bashkëshorten e subjektit) që në emër dhe për llogari të tyre të paraqitet pranë BKT-së dhe të plotësojë çdo lloj akti dhe veprimi procedural për tërheqjen e shumës 15.000 euro të depozitës së tyre pranë kësaj banke.

109. Gjithashtu, këta shtetas kanë lëshuar një deklaratë noteriale në datën 13.7.2012, me palë shtetasit L, M.Sh dhe J.Sh, me të cilën deklarojnë se kjo e fundit i ka marrë hua shumën 15.000 euro për nevoja familjare, për efekt banimi. Kjo shumë do të kthehet në të njëjtën vlerë për një afat të pacaktuar, por jo më vonë se 10 vjet.

110. Dokumentacioni i depozituar në mbështetje të këtyre fakteve:

- deklaratë noteriale, datë 13.7.2012, me palë shtetasit L, M dhe J.Sh;
- mandat tërheqje bankare, datë 2.7.2012, lëshuar nga BKT, me të cilin shtetasja J.Sh ka tërhequr shumën 15.000 euro nga depozita me afat 6-mujor e shtetasve L ose M.Sh;
- kontratë depozite bankare, datë 26.6.2013, lidhur midis BKT-së dhe depozitueses M.Sh, me qëllim depozitim për një periudhë 1-vjeçare të shumës 40.276 lekë;
- kontratë depozite bankare, datë 9.9.2015, lidhur midis BKT-së dhe depozituesve L ose M Sh, me qëllim depozitim për një periudhë 1-vjeçare të shumës 53.313 euro.

111. Subjektit i është kërkuar nga Komisioni që të provojë burimet e ligjshme të huadhënësve, që kanë shërbyer për dhënien e huas, në përputhje me nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka shpjeguar se: *“Në lidhje me shumën 15.000 euro të marra hua nga vëllai dhe kunata ime L.Sh dhe M. Sh për blerjen në vitin 2012 të apartamentit në Tiranë, ju bëjmë me dije se vëllai im ka një familje të përbërë nga katër anëtarë. Vëllai nga viti 1999 e në vazhdim ka jetuar dhe jeton së bashku me familjen e tij në qytetin e K, Greqi. Aktualisht ndodhet në Gjermani së bashku me familjen e tij. Gjatë kohës së qëndrimit në Greqi ka punuar në mënyrë të ligjshme, duke marrë dhe fitimet e pasqyruara në pagesat vjetore të kryera prej tij në vite”.*

112. Subjekti, për të provuar burimet e ligjshme të huadhënësve L dhe M.Sh, ka depozituar:

- vërtetim përkthimi nga gjuha greke, me nr. *** - *** rep., datë 24.12.2021, të dokumentit me përshkrimin “formular likuidimi i tatimit mbi të ardhurat e personave fizikë mbi bazën e deklaratës fillestare”, për vitet 2003 – 2016.

113. Komisioni analizoi dokumentacionin e depozituar për të ardhurat e shtetasve M dhe L. Sh, si dhe shpenzimet sipas standardit të Eurostat-it për Greqinë ndër vite. Në lidhje me të dhënat bankare në Shqipëri, referuar lëvizjeve të llogarisë të hapur në BKT, ka rezultuar se shtetasit L dhe M. Sh kanë hapur disa depozita, si më poshtë vijon:

- depozitë në shumën 5.000 euro, në datën 24.5.2010 (depozitim *cash*);
- depozitë në shumën 12.500 euro, në datën 30.12.2010 (depozitim *cash*);

³⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2020.

³¹Me shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2020.

- depozitë në shumën 12.500 euro, në datën 28.6.2011 (depozitim *cash*).

114. Nga verifikimi i të dhënave bankare evidentohet tërheqja e shumës 15.000 euro në datën 2.7.2012 dhe gjendja e llogarisë në momentin përpara tërheqjes së huas ishte në shumën 30.643 euro, pra, provohet me dokumentacion shumë e tërhequr, e cila mund të ketë shërbyer si burim për huan. Pavarësisht këtij fakti, Komisioni analizoi të ardhurat e ligjshme të huadhënësit dhe bashkëshortes së tij nga punësimi në Greqi.

115. Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se huadhënësit kanë blerë në datën 28.4.2004 një apartament në Korçë, në shumën 1.900.000 lekë (konvertuar në 14.991 euro sipas kursit të këmbimit të vitit 2004). Gjithashtu, ka rezultuar se subjekti ka deklaruar dhurim në shumën 3.000 euro nga vëllai L.Sh në vitin 2007. Referuar të dhënave të depozituara, Komisioni analizoi të ardhurat e ligjshme të huadhënësit dhe mundësitë financiare të shtetasve L dhe M.Sh për të dhënë huan në shumën 15.000 euro. Në këtë analizë janë reflektuar të ardhurat sipas dokumentacionit të depozituar nga subjekti, ndërsa shpenzimet jetike familjare janë bazuar në të dhënat zyrtare të Eurostat-it.

Vlerësimi i Komisionit për huadhënësit L dhe M.Sh

116. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se huadhënësit L dhe M.Sh nuk kishin mundësi financiare të jepnin huan, pasi nuk justifikojnë me burime të ligjshme financiare huan e dhënë në vitin 2012 në shumën 15.000 euro, për pasojë, huaja nuk është përfshirë në analizën financiare të subjektit.

Konstatime të Komisionit në lidhje me apartamentin e blerë në Tiranë

- Nga analiza financiare e kryer mbi mundësitë e subjektit për krijimin e kursimeve në shumën 2.921.954 lekë për periudhën 2005 – 2012, të cilat janë përdorur për blerjen e apartamentit, ka rezultuar mungesë burimesh të ligjshme, për të krijuar likuiditetet dhe përballuar shpenzimet në shumën totale prej 678.111 lekë.
- Huadhënësit L dhe M.Sh nuk justifikojnë me burime të ligjshme financiare huan e dhënë në vitin 2012, në shumën 15.000 euro, për pasojë huaja nuk është përfshirë në analizën financiare.

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit pas kalimit të barrës së provës

117.i. Në lidhje me gjendjen negative të konstatuar nga Komisioni, për kursimet e tij dhe të bashkëshortes, të cilat ishin përdorur si një nga burimet për blerjen e apartamentit në Tiranë për periudhën deri në vitin 2012, kur u ble apartamenti, subjekti ka pretenduar si vijon:

- Në analizën financiare të hartuar nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se janë llogaritur shpenzimet e jetesës për 6 persona (përfshirë prindërit e subjektit), ndërkohë që në këtë analizë nuk janë përfshirë të ardhurat e prindërve përfituara nga pensionet e pleqërisë. Duke qenë se subjekti ka jetuar me prindërit në një shtëpi, ka kërkuar nga Komisioni të përfshihen në analizën financiare të ardhurat e tyre nga pensionet, si të ardhura të ligjshme të cilat i vinë familjes së tij.

Subjekti i ka bashkëlidhur prapësimeve dokumentacion provues³³, që janë pensionet e nënës dhe babait të mara në institucionin e Sigurimeve Shoqërore, dega Korçë.

- Subjekti ka pretenduar se në analizën financiare të kryer nga Komisioni në vitin 2007 nuk është përfshirë shuma prej 3.000 euro, dhuruar nga i vëllai L.Sh, shumë e cila është deklaruar prej tij edhe në DPV-në përkatëse. Subjekti i ka kërkuar Komisionit që kjo shumë të përfshihet në analizë si e ardhur e ligjshme.

117.ii. Në lidhje me konstatimet e Komisionit se huadhënësit L dhe M.Sh ishin në pamundësi financiare për të dhënë shumën prej 15.000 euro, subjekti ka pretenduar se:

- Analiza ligjore e kryer nga Komisioni në lidhje me huadhënësit e shumës 15.000 euro nuk është në përputhje me parashikimet ligjore, pasi sipas subjektit personi tjetër i lidhur, në këtë rast vëllai i tij, është i detyruar të japë shpjegime deri në shumën e dhënë hua dhe vendosja e tij në kushte të barabarta me një subjekt rivlerësimi tejkalon parashikimet dhe detyrimet ligjore.

Subjekti shpjegon se ky pretendim gjën mbështetje në vendimin nr. 15, datë 17.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm i Apelit, ku është vendosur standardi, si vijon: *“...Kolegji çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj pasurie konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai është ngarkuar ligjërisht të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur...”*

- Në vijim të shpjegimeve të tij në lidhje dhe situatën financiare të huadhënësit, subjekti ka pretenduar se familja e vëllait është në emigracion që nga viti 1991 e në vijim dhe si çdo familje emigrantësh kanë punuar dhe përfituar të ardhura pa u formalizuar, shpeshherë duke bërë edhe nga dy punë, por të pa regjistruar në institucionet tatimore dhe kjo ka ardhur jo për faj të tyre.

Subjekti ka pretenduar se nëse Komisioni nuk përfshin të ardhurat e përfituara nga puna e tyre në analizë për shkak të mosdokumentimit të tyre, duhet të ketë në konsideratë këtë fakt në përlllogaritjen e shpenzimeve për jetesë. Komisioni nuk duhet të llogarisë shpenzimet e jetesës së familjes së vëllait sipas standardit të Eurostat-it për qytetarët grekë, pasi është fakt se emigrantët shqiptarë bëjnë jetë më të thjeshtë dhe modeste sesa qytetarët e tjerë të Komunitetit Evropian.

- Subjekti ka shpjeguar se familja e vëllait, përveç të ardhurave të përfituar nga punësimi i ligjshëm sipas dokumentacionit të depozituar gjatë hetimit, ka përfituar “kompensim” periodik nga shteti grek, si një ndihmë nga shteti për të mbuluar shpenzimet e qirasë, asistencë sociale dhe ndihmë për fëmijë, kompensim i cili ka filluar të aplikohet që në vitin 2005.

Subjekti shpjegon se për periudhën 2005 – 2011 kompensimi nga shteti ka qenë në shumën 16.850 euro, të ardhura të cilat nuk janë të tatueshme dhe kanë kaluar çdo muaj në llogarinë bankare të huadhënësve. Këto shuma janë të mjaftueshme për dhënien e huas subjektit të rivlerësimit.

³³Vërtetim pensioni pleqërie nr. *** prot., datë 13.9.2022, lëshuar nga ISSH-ja Korçë për shtetasin H.R.Sh, si dhe vërtetim pensioni pleqërie nr. *** prot., datë 13.9.2022, lëshuar nga ISSH-ja Korçë për shtetasen F.N.Sh.

- Në vijim, subjekti shpjegon se shumat e kursyera nga familja e të vëllait nga punësimi dhe kompensimi në Greqi janë shuma të depozituara në Bankën Kombëtare Tregtare në Shqipëri përpara se t'i jepeshin subjektit si hua dhe janë provë që janë disponuar përpara se t'i lindte nevoja për të marrë këtë hua.

Subjekti pretendoi se nga të dhënat e nxjerra për huadhënësit nga llogaria bankare në Bankën Kombëtare Greke, duket se deri në maj të vitit 2010 gjendja e llogarisë ka arritur vlerën 22.546,43 euro. Në vitin 2010 janë tërhequr nga kjo llogari shuma 5.000 euro në datën 21.5.2010 dhe shuma 11.780 euro deri më 24.8.2010. Këto veprime korrespondojnë me depozitimet *cash* që janë kryer në BKT, përkatësisht 5.000 euro në 24.5.2010 dhe 12.500 euro në datën 30.10.2010.

Për sa u argumentua më sipër dhe akteve të depozituara³⁴, subjekti kërkon nga Komisioni të konsiderojë shumën e dhënë hua nga vëllai, si shumë të krijuar me burime të ligjshme dhe ta përfshijë në analizën financiare të kryer për subjektin.

Vlerësimi i Komisionit për apartamentin në Tiranë

118.i. Në lidhje me kursimet e përdorura për blerjen e apartamentit në Tiranë, pas analizimit të akteve të depozituara nga subjekti dhe pretendimeve të tij, Komisioni vlerëson të drejtë pretendimin e subjektit në lidhje me përfshirjen në analizën financiare të shumave të përfituara nga pensioni i prindërve të tij ndër vite deri në vitin 2012, kur është blerë apartamenti, kjo edhe për faktin se subjekti ka banuar me prindërit gjatë gjithë kohës.

Komisioni, pas prapësimeve, kreu analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, duke përfshirë të ardhurat e dokumentuara të përfituar nga pensioni i prindërve, sipas dy vërtetimeve të lëshuara nga ISSH Rajonale Korçë. Pas reflektimit në analizë financiare të pensioneve të prindërve dhe dhuratës së shtetasit L.Sh për periudhën 2005 – 2012, balanca ka rezultuar pozitive.

Për pasojë, Komisioni vlerëson se subjekti ka burime të mjaftueshme financiare për të krijuar kursimet në shumën 2.921.954 lekë, si një nga burimet për blerjen e apartamentit në Tiranë.

118.ii. Në lidhje me huan në vlerën 15.000 euro, dhënë nga shtetasit L dhe M.Sh, Komisioni, pas vlerësimit të pretendimeve dhe provave të depozituar nga subjekti, arsyeton se referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin që personat e lidhur me të, të deklaruar në cilësinë e huadhënësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie kanë detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave.

³⁴Në mbështetje të këtyre pretendimeve subjekti ka depozituar: vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë 17.9.2022, të një dokumenti lëshuar nga Banka Kombëtare e Greqisë, me përshkrimin “Gjendja e lëvizjes analitike të llogarisë së depozitës ***, që fillon nga data 7.1.2002 – 29.6.2022”; vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë 14.9.2022, dokument i lëshuar nga Banka Kombëtare e Greqisë, me përshkrimin “Librezë kursimi e përbashkët me përfitues L e M.Sh” në monedhën euro dhe dhrahmi, për periudhën 12.9.2001 – 8.12.2003; vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë 14.9.2022, dokument i lëshuar nga Banka Kombëtare e Greqisë, me përshkrimin “Librezë kursimi e përbashkët me përfitues L e M.Sh” në monedhën euro dhe dhrahmi, për periudhën 12.9.2001 – 8.12.2003; vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë 14.9.2022, dokument i lëshuar nga Banka Kombëtare e Greqisë, me përshkrimin “Librezë kursimi e përbashkët me përfitues L e M.Sh” në monedhën euro, për periudhën 5.7.2007 – 17.2.2010; vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë 14.9.2022, dokument i lëshuar nga Banka Kombëtare e Greqisë, me përshkrimin “Librezë kursimi e përbashkët me përfitues L e M.Sh” në monedhën euro, për periudhën 8.3.2010 – 5.4.2013; vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë 14.9.2022, dokument i lëshuar nga Banka Kombëtare e Greqisë, me përshkrimin “Librezë kursimi e përbashkët me përfitues L e M.Sh” në monedhën euro, për periudhën 28.4.2013 – 27.6.2017.

Në lidhje me këtë hua, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka provuar marrëdhënien e huadhënies me vëllain dhe kunatën sipas deklaratë noteriale në datën 13.7.2012 dhe dhënia e huas është bërë me transaksion bankar.

Në lidhje me mundësitë financiare të huadhënësve, Komisioni mori në konsideratë provat e reja të sjella nga subjekti për burimet e ligjshme të huadhënësve³⁵, duke përfshirë të ardhurat e ligjshme të përfituar nga këta shtetas në analizën financiare referuar akteve.

Komisioni përfshiu në analizën financiare, të kryer pas prapësimeve, të ardhurat shtesë të përfituara nga familja e vëllait, si kompensim dhënë nga shteti grek në shumën totale 16.859 euro. Nga kjo analizë, huadhënësi rezultoi sërish me balancë negative.

Pra, nga analiza financiare e kryer rezultoi se huadhënësi nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të dhënë huan në shumën 15.000 euro dhe për të përballuar shpenzimet e tij të jetesës, pasi nga analiza financiare e kryer për periudhën 2005 – 2011 rezultoi balancë negative në shumën 21.182 euro. Për pasojë, shuma e huas nuk u konsiderua si burim i ligjshëm në analizën përfundimtare të kryer nga Komisioni.

119. Në konkluzion, nuk u provuan bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë apartament në Tiranë, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

120. Detyrimet financiare të subjektit dhe bashkëshortes

a. Hua në euro pa interes, marrë nga bashkëshortja e subjektit kunatit dhe kunatës, L dhe M.Sh, me qëllim blerje shtëpie banimi në Tiranë. Shuma totale prej 15.000 euro është tërhequr në Bankën Kombëtare Tregtare, dega Korçë, në datën 2.7.2012. Afati i shlyerjes së detyrimit është 10 vjet, duke filluar nga data 13.7.2012.

- Shuma e mbetur pa shlyer në deklaratën *Vetting* është 6.000 euro.

b. Hua pa interes në shumat 5.700 euro dhe 25.000 USD marrë nga bashkëshortja e subjektit vëllait të saj M.Gj, me qëllim blerje shtëpi banimi në Tiranë.

- Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si të mbetur pa shlyer shumën e plotë të huas.

Analiza financiare

121. Nga verifikimi i akteve rezulton se subjekti në deklaramet periodike në vite ka deklaruar saktë huat.

Në lidhje me huan e marrë nga shtetasit L dhe M.Sh, ka rezultuar se deklarimi i shlyerjeve nuk përkon me depozitimet që ka kryer bashkëshortja në llogarinë e huadhënësit në BKT.

122. Nga verifikimi i deklarimeve dhe depozitimeve *cash* të kryera në BKT në llogarinë e shtetasve L dhe M.Sh, ka rezultuar se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, pasi shuma e depozitimeve *cash* në BKT është 10.100 euro, ndërsa shuma e deklaruar si e shlyer fizikisht është 9.000 euro.

Konstatimet e Komisionit

- Nuk është deklaruar saktë shlyerja e detyrimit për shtetasit L dhe M.Sh.

³⁵Sipas akteve listuar në *footnote*-ën nr. 34, më sipër.

- Nëse do të analizohej mundësia e shlyerjes në vite, sipas deklarimeve periodike vjetore, do të rezultonte një balancë negative në shumën 112.301 lekë për vitin 2014.
- Subjekti nuk ka deklaruar depozitimet në llogarinë e shtetasve M dhe L.Sh në shumën totale prej 10.100 euro në periudhën 2013 – 2014, si dhe burimin e krijimit të këtyre shumave.

Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Prapësimet e subjektit

i. Në lidhje me konstatimin e Komisionit për mosdeklarim të depozitimeve në llogarinë e shtetasve L dhe M.Sh të shumës 10.100 euro, si dhe mospërputhjen e deklarimeve të subjektit për shumat e shlyera ndaj huadhënësve, subjekti ka shpjeguar se *Komisioni gabimisht është ngatërruar, për sa ka bërë llogaritjen e mësipërme në lidhje me këtë fakt, pasi shumat e paguara nga bashkëshortja e tij në llogarinë bankare të shtetasve M dhe L.Sh, 10.100 euro, nuk përfaqësojnë shlyerjen e huas. Këto janë likuiditete të sjella në Shqipëri nga vëllai i subjektit herë pas here, për t'u depozituar në bankë në Shqipëri dhe në pamundësi për t'u paraqitur në bankë për t'i depozituar në llogari personalisht, këto derdhje janë bërë nga bashkëshortja e subjektit, duke qenë se ajo kishte autorizim për të bërë këto depozitime.*

123. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka depozituar:

- Autorizim lëshuar nga shtetasi L.Sh, i cili autorizon shtetasen J.Sh që të bëjë derdhje në llogarinë nr. *** çdo lloj shume në euro, me afat 1 vit. Nga derdhjet që ka kryer bashkëshortja e subjektit në llogarinë e shtetasve L dhe e M.Sh për vitet 2013 - 2014, provojnë faktin që ato janë bërë brenda 1 viti sipas autorizimit (datë 5.8.2013 derdhja e parë dhe datë 22.5.2014 derdhja e katërt).
- Deklarata që kanë bërë para noterit vëllai dhe kunata e subjektit, L dhe M.Sh, në lidhje me autorizimin e shtetasen J.Sh për të derdhur në llogarinë e tyre shumat në euro që sillnin nga Greqia dhe që i përkasin katër rasteve në vitet 2013 - 2014.

ii. Lidhur me konstatimin e Komisionit për pamundësinë e shlyerjes së huas në vitin 2014 në shumën 112.301 lekë për vitin 2014, subjekti ka pretenduar se ky konstatim nuk është i saktë, për arsye se në analizën financiare të kryer nga Komisioni nuk janë marrë në konsideratë dhe përfshirë në analizë të ardhurat nga pensionet e prindërve të subjektit. Përgjatë gjithë periudhës së analizuar janë përlllogaritur shpenzime për jetesë për gjashtë anëtarë, pra duke përfshirë edhe prindërit, por janë përjashtuar të ardhurat e tyre nga pensioni. Subjekti ka shpjeguar se në vitin 2014 prindërit e tij kanë siguruar të ardhura bashkërisht nga pensionet, në shumën 399.164 lekë.

Vlerësimi i Komisionit

i. Në lidhje me pretendimin e paraqitur nga subjekti se shuma 10.100 euro, derdhur në llogarinë e shtetasve L dhe M.Sh nga bashkëshortja e subjektit, nuk përfaqëson shlyerjen e huas së marrë prej tyre, por janë para të sjella nga vëllai dhe bashkëshortja në Shqipëri dhe për lehtësi i ka derdhur bashkëshortja e tij J.Sh, Komisioni nuk i vlerëson si bindëse këto shpjegime, pasi:

- Referuar dokumentit të sjellë nga subjekti pas prapësimeve, në llogarinë nr. ***, e përkthyer dhe noterizuar në datën 14.9.2022 me nr. *** rep., lëshuar nga Banka Kombëtare Greke, nga analizimi i llogarisë bankare të shtetasve L dhe M.Sh nuk evidentohet tërheqje që në total të përbëjë shumën

prej 10.100 euro. Në fillim të vitit 2013 gjendja e llogarisë në Bankën Greke ka rezultuar të jetë rritur nga 5.600 euro dhe në fund të vitit 2014 gjendja e llogarisë është rritur me shumën 8.600 euro. Pra, nuk rezulton e provuar nga dokumentacioni bankar i administruar pretendimi i subjektit se këto para janë sjellë nga i vëllai në Shqipëri dhe më pas janë depozituar nga bashkëshortja e subjektit.

ii. Në lidhje me mundësinë e subjektit për të shlyer huan sipas deklarimeve të tij në DPV, Komisioni vlerëson si të drejtë pretendimin e subjektit për të përfshirë në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga prindërit e subjektit për vitet 2013 dhe 2014. Nga analiza financiare e rikryer nga Komisioni pas përfshirjes të pensioneve, subjekti rezultoi me balancë pozitive, pra kishte mundësi financiare për të shlyer huan me burime të ligjshme sipas deklarimeve të subjektit në DPV-të përkatëse.

124. Deklarimi i të ardhurave të subjektit

ILDKPKI-ja ka konstatuar:

- Mosdeklarim i të ardhurave në shumën 34.167 USD, të përfituara nga puna e subjektit në SHBA për periudhën 2008 – 2015.
- Është e paqartë marrëdhënia juridike e punësimit që subjekti ka pasur për realizimin e të ardhurave të tij në SHBA gjatë periudhës 2008 – 2016, në shumën 39.467 USD.
- Subjekti nuk ka deklaruar destinacionin e përdorimit të shumës totale 39.467 USD, në periudhën 2008 – 2016.
- Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratimet e interesave private ndër vite dhe në deklaratën *Vetting* adresën e banimit “** H.A.W CT **”, referuar dokumentacionit të paraqitur. Gjithashtu, nuk është e qartë marrëdhënia juridike që subjekti dhe personat e lidhur kanë me pasurinë që i përket kësaj adrese.

125. Të ardhurat e deklaruara nga subjekti

Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhurat nga punësimi i ligjshëm i tij dhe i bashkëshortes në Shqipëri, për të cilat, nga hetimi i kryer, nuk rezultuan problematika.

126. Të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga subjekti dhe bashkëshortja në SHBA

Subjekti, në deklaratën *Vetting*, për herë të parë ka deklaruar të ardhura të përfituara nga punësimi i tij dhe i bashkëshortes në SHBA për periudhën 2008 – 2016, në shumën 80.945 USD.

127. Të ardhurat e deklaruara nga vajza e subjektit

- Të ardhurat e vajzës së subjektit deklarues nga paga e marrë në punën *part-time* të kryer në shkollën ku studion *G.C.C* në shtetin Connecticut, SHBA, në harkun kohor 1.1.2015 - 31.12.2015, në shumën 2.745,01 USD.
- Të ardhurat e vajzës së subjektit deklarues nga paga e marrë në punën *part-time* të kryer në shkollën ku studion *G.C.C* në shtetin Connecticut, SHBA, për harkun kohor 1.1.2016 – 31.12.2016, në shumën 6.879,3 USD.
- Të ardhurat e vajzës së subjektit deklarues nga paga e marrë në punën *BP G.S* (pikë karburanti) në shtetin Connecticut, SHBA, për harkun kohor 1.1.2016 – 31.12.2016, në shumën 2.121,6 USD.

128. Komisioni³⁶ i ka kërkuar subjektit informacion dhe dokumentacion provues për të ardhurat e krijuara në SHBA, duke specifikuar natyrën e punës së kryer prej tij dhe bashkëshortja, kontratat e punëve përkatëse, lidhjen që kanë pasur me punëdhënësit për ditët e qëndrimit në SHBA, dokumentacion provues për pagesat e detyrimeve tatimore, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Kushtetutës, si dhe dokumentacion provues që subjekti i ka deklaruar këto të ardhura në hyrje të territorit shqiptar, si dhe destinacionin e këtyre shumave të përfituara në vite.

129. Subjekti, në mbështetje të pretendimeve të mësipërme, ka depozituar 8 dokumente në gjuhën angleze, me përshkrimin “Pagim taksash si i vetëpunësuar”, për vitet 2008 – 2015, për vete dhe bashkëshorten e tij, me të cilat provohet pagimi i taksave në SHBA për të ardhurat e përfituara për shumën totale prej 64.684 USD.

Konstatimet e Komisionit

- Subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë deklaruar në DPV-të në vite të ardhurat e përfituara në shumën 80.945 USD nga puna e tyre në SHBA, për periudhën 2008 – 2016.
- Nuk përputhen deklaratimet e subjektit në lidhje me shumën e përfituara në SHBA, pasi në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si të përfituar nga punësimi i tij dhe i bashkëshortes shumën 80.945 USD, ndërkohë që nga dokumentacioni i depozituar rezulton se ai ka paguar taksa për shumën e përfituar nga punësimi i tij dhe i bashkëshortes në shumën 64.684 USD.
- Është e paqartë marrëdhënia juridike e punësimit që subjekti ka pasur për realizimin e të ardhurave të tij në SHBA gjatë periudhës 2008 – 2016, në shumën 40.700 USD.
- Subjekti nuk ka deklaruar destinacionin e përdorimit/shpenzimet e shumës totale 80.945 USD, për periudhën 2008 – 2016.
- Deklarim të pasaktë në lidhje me shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit në SHBA, pasi subjekti ka deklaruar se shumën e përfituara në shtetin amerikan janë përdorur për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit dhe të jetesës në SHBA, por në përgjigjet e pyetësorit mbi shpenzimet e udhëtimeve ndër vite ka deklaruar se shpenzimet e qëndrimit janë mbuluar nga miqtë e familjes dhe se ka jetuar në shtëpitë e tyre pa shpenzime të familjes së tij.
- Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratimet e interesave private ndër vite dhe në deklaratën *Vetting* adresën e banimit “** H.A.W CT **”. Gjithashtu, nuk është e qartë marrëdhënia juridike që subjekti dhe personat e lidhur kanë me pasurinë që i përket kësaj adrese.
- Për vitet ku është kaluar limiti i shpenzimeve të deklarueshme, subjekti nuk ka deklaruar në DPV-të periodike shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi në SHBA, të tij dhe të anëtarëve të familjes.

Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit

130. Në lidhje me konstatimet e Komisionit për të ardhurat e krijuara në SHBA, subjekti ka shpjeguar:

³⁶Me pyetësorin e datës 15.12.2021.

i. Në lidhje e mosdeklarimit ndër vite të këtyre të ardhurave të fituara në SHBA, kjo është bërë duke menduar se të gjithë anëtarët e familjes së tij nga viti 2004 e në vazhdim janë rezidentë në SHBA dhe ekzistenca në këtë vend me të drejta të plota krijonte edhe detyrimin për pagim taksash. Në këto kushte, subjekti ka shpjeguar se detyrimet për taksat në dy vende të ndryshme i takon atij vendi ku gjenerohen të ardhurat dhe ku paguhen këto taksa, për këtë arsye, të ardhurat janë deklaruar në vendin ku janë krijuar.

Gjithashtu, subjekti, për faktin e mosdeklarimit të punës së kryer dhe të ardhurave të krijuara në këtë vend, ka shpjeguar se në SHBA ka bërë punë të thjeshta/punë krahu dhe për shkak të detyrës së prokurorit që kishte në Shqipëri dhe reputacionit që ka ky funksion, e ka pasur të vështirë të tregonte punën që ka bërë në SHBA.

ii. Në lidhje me mospërputhjen që ka konstatuar Komisioni për shumat 80.945 USD dhe 64.684 USD (për të cilën rezulton se janë paguar taksat), subjekti ka shpjeguar se shuma 80.945 USD është e fituar nga çeket në SHBA, provuar kjo në bazë të çekut të marrë, ndërsa shuma 64.684 USD është e fituar *neto*, pra pas mbajtjes së tatimeve, pasi tatimet gjithmonë paguheshin në vitin pasardhës dhe deklarimi është i shumës totale të përfituar. Shuma 64.684 USD reflekton vetëm vitet 2008 - 2015, ku nuk janë përfshirë të ardhurat e përfituara në vitin 2016. Bashkë me të ardhurat e vitit 2016, shuma totale shkon 75.410 USD, të përfituara nga puna në SHBA.

iii. Lidhur me marrëdhënien juridike të punësimit, subjekti ka shpjeguar se ai dhe bashkëshortja kanë punuar si të vetëpunësuar dhe punën e siguronte nga i njohuri i familjes, referuar kjo edhe deklaratave të lëshuara nga këta shtetas.

iv. Të ardhurat e siguruara nga punësimi janë përdorur përgjatë viteve për mbulimin e shpenzimeve të ndryshme, duke filluar që nga pagesat për biletat, shpenzime transporti, blerje të ndryshme veshjesh etj. Nuk kanë kaluar në një blerje të vetme shumë e parashikuar për deklarim. Në shpenzimet bëjnë pjesë edhe pagesat e taksave të ndryshme.

v. Subjekti ka shpjeguar se nuk konstaton pasaktësi në deklarim për shkak se ai dhe familja kanë qëndruar në banesën e miqve të tyre në adresën “** H, A, W CT **”. Kjo adresë është deklaruar në çdo dokument të tij dhe të familjes.

vi. Gjithashtu, në lidhje me shpenzimet për qëndrimin në SHBA, subjekti ka shpjeguar se mikpritja e këtyre shtetasve ka qenë në lidhje me fjetjen dhe me shpenzimet e ushqimit. Pavarësisht mikpritjes dhe bujarisë, subjekti shpjegoi se kanë kontribuar për aq sa kanë mundur që të mos bëheshim barrë e rëndë për ta. Shpenzimet e tjera të cituara më sipër janë mbuluar prej tyre (bashkëlidhur subjekti ka depozituar deklaratën e miqve të tyre).

vii. Subjekti ka saktësuar se adresa e banimit në SHBA ka qenë “** H, A, W CT **”. Ky fakt provohet me dokumentet që disponon si, leja e drejtimit, pagimi i taksave apo letra të ndryshme që dërgoheshin në emër të subjektit dhe të familjarëve të tij.

Kjo adresë ka qenë deri në vitin 2014, pasi më pas adresa e tij dhe e familjes ka qenë “*** L.T (TPKE) W CT ***”, në vendin ku vajza dhe djali i tij kanë kryer shkollën.

viii. Në lidhje me mosdeklarimin prej tij të shpenzimeve në SHBA, subjekti ka shpjeguar se prej tij është kuptuar gjithmonë se detyrimi për deklarim është për një shpenzim të vetëm që kalon vlerën e 300.000 lekëve, si një zë më vete. Kuptuar kështu, subjekti saktëson se nuk ka pasur një

shpenzim të vetëm që kalon këtë shumë, për të cilin të kishte detyrimin për deklaram. Biletat e avionit, si një zë shpenzimi i lartë, nuk arrinin vlerën mbi 300.000 lekë.

Vlerësimi i Komisionit

131. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga familja e subjektit në SHBA dhe të padeklaruara ndër vite, Komisioni vlerëson se subjekti ka pasur detyrim ligjor të deklaronte shumat e plota të përfituara nga punësimi i tij, bashkëshortes dhe vajzës në SHBA, nga vitit 2008 e në vijim në deklaratat periodike vjetore. Ky detyrim i subjekteve deklarues është parashikuar në germën “e”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ku referohet se: *“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë ..., brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale”*.

Subjekti, në deklaratën *Vetting*, ka korrigjuar pasaktësitë në lidhje me deklaramin e të ardhurave të përfituar në SHBA dhe ka deklaruar shumat e përfituara sipas vërtetimeve përkatëse. Komisioni, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, arsyeton se pasaktësitë në deklaramin e të ardhurave, të pa shoqëruar me mungesë burimesh të ligjshme, nuk janë penalizuese për subjektin e rivlerësimit. Ky qëndrim vlen edhe për pasaktësitë në deklaramet e tjera të subjektit, për sa i përket shpenzimeve të udhëtimit/shkollimit apo qëndrimit në SHBA.

132. Automjet tip “Audi A*”, viti i prodhimit 2002, blerë në vitin 2014 në shumën 300.000 lekë, në pronësi të bashkëshortes së subjektit, me burim të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes, përfituar nga punësimi i tyre

133. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se DPSHTRR-ja³⁷ ka konfirmuar se shtetasja J.Sh ka në pronësi automjetin me targa AA *** IR.

134. Nga të dhënat e sistemit AMF konfirmohet se shtetasja J.Sh ka në pronësi automjetin tip “Audi”, me targa AA *** IR, vit prodhimi 2002, dhe është pajisur rregullisht me siguracion të detyrueshëm për automjetet për vitet 2015 – 2022.

135. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë³⁸ ka informuar se në emër të shtetasit K.S.H (shitësi i automjetit tip “Audi”) është regjistruar procedimi penal nr. *** i vitit 2012, ndjekur në gjykim nga prokurori E. S., për veprën penale të parashikuar nga neni 248-25 i Kodit Penal. Ky shtetas është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me 2 vjet burg. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. **, datë 13.2.2015, ka vendosur pushimi i çështjes.

Konstatime të Komisionit për blerjen e automjetit

136. Komisioni kreu analizën financiare deri në momentin e blerjes së automjetit në datën 6.3.2014, nisur nga fakti që në DPV-në e vitit 2013 subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*, për të vlerësuar mundësinë e blerjes me burime të ligjshme të automjetit. Nga analiza financiare e kryer për vitin 2014, subjekti ka rezultuar me një balancë negative për blerjen e automjetit, si dhe

³⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

³⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2022.

kryerjen e shpenzimeve në shumën 206.095 lekë. Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës.

Qëndrimi i subjektit

137. Subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke pretenduar se nuk qëndron gjendja negative e rezultuar nga analiza e kryer për vitin 2014, pasi në vitin 2013 ka deklaruar gjendje *cash* në fund të vitit, e cila, pas llogaritjeve të kryera, rezulton në shumën 160.240 lekë.

138. Subjekti ka shpjeguar se ky fakt është pranuar dhe konkretizuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni, ku në fund të këtij viti në analizën e përgjithshme financiare kanë përfshirë si gjendjet bankare të subjektit dhe të bashkëshortes, por edhe gjendjen *cash* në shumën 160.240 lekë. Kësaj shume i shtohen edhe kursimet deri në 6.3.2014, kur është blerë automjeti.

Vlerësimi i Komisionit

139. Komisioni, pas analizimit të pretendimeve të subjektit, verifikimit të deklarimeve të subjektit në DPV-në e vitit 2013, verifikimit të bankave të subjektit, si dhe duke përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga pensioni i prindërve, analiza financiare për blerjen e automjetit ka rezultuar me gjendje pozitive.

Përfundimisht, u provuan të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e automjetit, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

140. Shkollimi i fëmijëve

Nga deklaratimet e subjektit rezulton se:

- e bija J.Sh, lindur më 26.7.1996, nga dhjetori i vitit 2014 ka shkuar për studime në SHBA;
- i biri E.Sh, lindur më 4.10.1999, në fund të muajit gusht 2016 ka shkuar për studime në SHBA.

141. Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar: *“Shpenzimet për studimet dhe jetesës për çdo vit kalendarik të kryera nga fëmijët e mi J dhe E.Sh janë përballuar nga puna e kryer nga vetë fëmijët, nga ndihma në formë borxhi të inkurajuar nga daja i tyre, shtetasi M.Gj, si dhe nga puna që kam kryer unë dhe bashkëshortja ime gjatë qëndrimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto të ardhura janë deklaruar në deklaratimet periodike vjetore dhe në dorëzimi i deklaratës Vetttig”.*

142. Nga verifikimi i deklaratimeve periodike vjetore rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar:

- shpenzime udhëtimi në SHBA për vete dhe familjen e tij;
- shpenzime jetese dhe shkollimi të dy fëmijëve në SHBA që nga viti 2014 e në vijim.

Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit

143. Subjekti ka pretenduar se shpenzimet e tij për udhëtime në SHBA për vete dhe familjarët e tij nuk kanë qenë në pragun e kërkuar për deklarim, në shumën 300.000 lekë, si një zë më vete si shpenzim.

- Në lidhje me shpenzimet e jetesës dhe shkollimit të dy fëmijëve të tij në SHBA që nga viti 2014, subjekti ka shpjeguar se nuk kanë përballuar shpenzime shkollimi për fëmijët, mbështetur në dokumentacionin provues me përshkrimin “Zyra e F.A: F.P.G (ndihma financiare nga SHBA) 7 copë për semestrat: pranverë 2015, verë 2015, vjeshtë 2015, pranverë 2016, verë 2016, vjeshtë 2016 (2 copë)”.

- Në lidhje me shkollimin e djalit të subjektit, kohëzgjatja e periudhës së gjimnazit vjeshtë 2016 – pranverë 2018 ka qenë pa shpenzime monetare.

Për sa i përket shpenzimit të shkollimit në periudhën 2015 – 2016 për të dy fëmijët janë në shumën 292 USD, të paguara nga vajza me të ardhurat e përfituara nga puna *part-time*. Për këtë arsye, subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasur shpenzime shkollimi për të deklaruar për fëmijët.

Vlerësimi i Komisionit

144. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nuk ka pasur detyrim për të deklaruar shpenzime shkollimi për fëmijët, pasi nuk kanë qenë në pragun e parashikuar nga ligji, si dhe ka depozituar dokumentacion të paqartë për të shpjeguar dhe provuar se fëmijët janë trajtuar me bursa, ndihma financiare nga shteti amerikan gjatë studimeve të tyre nga viti 2014 e në vijim. Subjekti ka depozituar 7 dokumente, me përshkrimin “Zyra e F.A: F.P.G (ndihma financiare nga SHBA), por dokumentet e depozituara nga subjekti duket sikur janë nxjerrë nga një sistem elektronik dhe nuk identifikon asnjë lloj institucioni arsimor që gjeneron sistemin apo këtë informacion, shuma totale e vitit shkollor, personi kujt i takon ky lloj informacion, etj.

145. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti ka bërë deklarim të pasaktë në lidhje me shpenzimet e shkollimit të fëmijëve dhe shpenzimet e jetesës në SHBA.

Analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003 – 2016

Vitet	Pasuri	Detyrime	Pasuri neto	Të ardhura	Shpenzime	Rezultati
1994 -2003	1 405 020	-	1 405 020	5 883 421	4 407 472	70 929
2004	-	-	-	1 470 850	879 691	591 159
2005	761 639	-	761 639	1 865 925	995 776	108 510
2006	576 633	-	576 633	1 623 343	942 736	103 974
2007	3 148 969	-	3 148 969	2 138 055	1 134 774	- 2 145 688
2008	197 000	-	197 000	1 817 279	1 423 953	196 325
2009	413 361	-	413 361	2 137 897	1 157 768	566 768
2010	703 021	-	703 021	3 230 407	1 805 006	722 380
2011	408 319	-	408 319	3 125 165	1 832 850	883 997
2012	5 798 726	3 538 310	2 260 416	3 130 903	1 882 347	- 1 011 860
2013	155 562	-	155 562	3 174 796	2 096 105	923 129
2014	497 945	-	497 945	3 587 990	2 814 508	275 537
2015	957 682	-	957 682	4 244 254	2 539 748	746 824
2016	589 537	-	589 537	3 926 640	2 754 212	582 891

Konkluzioni përfundimtar për vlerësimin e pasurisë

146. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludon se:

i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në deklaratën e pasurisë *Vetting*, sipas parashikimit të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, sipas parashikimit të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

147. Në këto rrethana, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, që përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

B. KONTROLLI I FIGURËS

148. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja ka dërguar një raport, të përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 4.8.2020, të KDZH-së. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

✓ Si konkluzion, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Edmond Shytko.

Vlerësimi i Komisionit

149. Komisioni ka kërkuar përditësim të raportit të dërguar nga DSIK-ja në vitin 2017, për të cilën nuk disponohen të dhëna të përditësuara për subjektin Edmond Shytko.

150. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

151. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit Edmond Shytko arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

152. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit të hartuar nga Këshillit i Lartë i Prokurorisë³⁹ për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve nga publiku të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

153. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- a. formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit;
- b. pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- c. të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, etj.

Përshkrimi i tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

154. Subjekti i rivlerësimit, prokurori Edmond Shytko, ka përzgjedhur tri dokumente ligjore për analizim nga ana e KLP-së, si vijon:

- i. kërkesë “Për gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2015”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë;
- ii. kërkesë “Për gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2016”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë;
- iii. kërkesë “Për gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2014”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

155. Nga verifikimi i dokumenteve ligjore të dorëzuara nga subjekti, janë konstatuar sa vijon:

i. Dokumenti ligjor - kërkesë për gjykim “Për procedimin penal nr. *** të vitit 2015”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

Subjekti i rivlerësimit Edmond Shytko, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në mbështetje të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, ka përpiluar kërkesën për gjykim të çështjes penale nr. *** të vitit 2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Nga akti nuk ka të dhëna nëse kërkesa për gjykim e kësaj çështjeje i është komunikuar të pandehurit, sipas parashikimit të nenit 331/3 të Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit, subjektit iu kërkua të shpjegojë nëse kërkesa për gjykim i është komunikuar të pandehurit.

ii. Dokumenti ligjor - kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2016”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

Nga aktet e administruara rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në datën 21.7.2016, bazuar në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale, ka dërguar për gjykim çështjen penale nr. *** të vitit 2016, në ngarkim të të pandehurit A. H., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “keqtrajtim i të miturit”, parashikuar nga neni 124/b/1 i Kodit Penal, në dëm të dy fëmijëve të tij të mitur.

³⁹Sipas aktit me shkresën nr. *** prot., datë 10.2.2021.

Nga akti nuk ka të dhëna nëse kërkesa për gjykim e çështjes penale i është komunikuar të pandehurit, sipas parashikimit të nenit 331/3 të Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit, subjektit iu kërkua të shpjegojë nëse kërkesa për gjykim i është komunikuar të pandehurit.

iii. Dokumenti ligjor - kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2014”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në ngarkim të dy të pandehurve për kryerjen e veprave penale “vjedhje me armë” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 140-25 i Kodit Penal dhe “vjedhje” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal.

Nga akti nuk ka të dhëna nëse kërkesa për gjykim e çështjes penale i është komunikuar të pandehurit, sipas parashikimit të paragrafit 3, të nenit 331, të Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkua të shpjegojë nëse kërkesa për gjykim i është komunikuar të pandehurit.

Prapësimet e subjektit

156. Për të tria dokumentet ligjore të analizuara nga Komisioni sa më sipër, për të cilat është i njëjti konstatim, subjekti ka shpjeguar se:

- për çështjen penale nr. *** të vitit 2015;
- çështjen penale nr. *** të vitit 2016; dhe
- çështjen penale nr. *** të vitit 2014,

nga aktet provohet se kërkesa për gjykim i është komunikuar të pandehurve, sipas nenit 331/3 të Kodit të Procedurës Penale.

157. Në mbështetje të shpjegimeve, subjekti ka depozituar:

- fotokopje të kërkesave për gjykim për të tria çështjet penale, ku rezulton se në njëërën prej tyre ka marrë njoftim vetë i pandehuri, në dy të tjerat janë marrë njoftim nga avokatët e tyre;
- shkresë përcjellëse për dërgimin e kërkesës për gjykim njërit nga avokatëve të zgjedhur nga i pandehuri.

158. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se shpjegimet e subjektit janë bindëse, bazuar edhe në provat e depozituara, ku rezulton se subjekti, në përputhje me nenin nenit 331/3 të Kodit të Procedurës Penale, i ka komunikuar kërkesën për gjykim të çështjes të pandehurve.

PËRSHKRIMI I 5 DOSJEVE PENALE DHE DOKUMENTEVE LIGJORE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

159. Subjekti i rivlerësimit Edmond Shytko rezulton se për periudhën e rivlerësimit ka qenë me detyrë prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë. Subjekti ka trajtuar 573 çështje, përfshirë edhe tri vendimet e përzgjedhura nga vetë ai.

160. Nga shorti i hedhur rezulton se u përzgjedhën në mënyrë rastësore një vendim për mosfillimin e procedimit penal, dy vendime pushimi dhe dy vendime për dërgimin e çështjes në gjyq. Nga pesë dosjet e vëzhguara, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime vetëm për dy prej tyre, si vijon:

161. Dokumenti ligjor - vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 6.9.2014, i takon kallëzimit penal nr. *** të vitit 2014, për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar

nga neni 89 i Kodit Penal. Kallëzimi është regjistruar pasi ka rezultuar se shtetasja Xh. Xh. (e mitur) në datën 12.8.2014 ka qenë së bashku me nënën e saj G. Xh. dhe u është afruar një person i gjinisë mashkull, dhe pa komunikuar me asnjërin prej tyre, i ka hedhur shtetasës Xh. Xh. vinovil në sy. Në vijim, së bashku me nënën e saj, është paraqitur në Komisarariatit e Policisë Korçë, ku ka paraqitur kallëzim penal për këtë fakt. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

162. Referuar akteve të analizuara nga Komisioni është konstatua se:

- Në akte nuk referohet shorti për caktimin e çështjes të subjekti i rivlerësimit. Në shkresë ka vetëm një mesazh të shkruar me dorë për referimin e veprës penale nga komisarati, por nuk është e qartë se kush e ka shkruar mesazhin (*Z. Edmond, administroje aktin e ekspertimit dhe më vonë ta diskutojmë. Datë 21.8.2014*).
- Ka një vendim të datës 12.8.2014 të punonjësit të policisë për kryerjen e raportit mjeko-ligjor, me qëllim identifikimin e dëmtimeve të shkaktuara në fytyrën e kallëzueses; nuk ka asnjë emër të mjekut ligjor të caktuar.
- Urdhri nuk përmban datë dhe orë kur do të kryhet ekspertiza; është firmosur nga nëna e kallëzueses.
- Ka një deklaratë të shkruar me dorë për urdhrin e mjekut ligjor Gj.K, i cili shkruan se shtetasja Xh.Xh nuk është paraqitur. Nuk ka asnjë datë për këtë deklaratë të shkruar me dorë.
- Sipas vendimit, prokurori i çështjes ka komunikuar përmes telefonit me shtetasen Xh.Xh, e cila kishte kërkuar mosvazhdimin e hetimeve (shënim, në dosjen hetimore nuk ka asnjë dokument të shkruar që të vërtetojë tërheqjen e shtetasës Xh.Xh nga hetimi).
- Në konkluzionet lidhur me vendimin mungon arsyetimi i faktit penal.

163. Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kërkua të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacion përkatës lidhur me veprimtarinë procedurale të ndjekur prej tij në dosjen objekt procedimi.

Qëndrimi i subjektit

164. Subjekti ka shpjeguar se si prokuror i këtij materiali kallëzues është njohur në datën 21.8.2014, pas 9 ditësh, kur zv.drejtuesi i Prokurorisë ka caktuar subjektin Edmond Shytko si prokuror të këtij kallëzimi.

- Subjekti ka shpjeguar se në kohën kur është regjistruar ky kallëzim përzgjedhja e prokurorit të çështjes nuk bëhej mbi bazën e një shorti, por prokurori i çështjes caktohej nga Drejtuesi i Prokurorisë apo zëvendësi i tij, në bazë të ngarkesës së secilit prokuror. Shënimi “*Z. Edmond administroje aktin e ekspertimit dhe më vonë ta diskutojmë. Datë 21.8.2014*” është i ish-zv.drejtuesit të Prokurorisë, prokurorit E.S, i cili ka hedhur firmën poshtë këtij shënimi. Pas marrjes së kallëzimit dhe njohjen me këtë kallëzim në datën 21.8.2014, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligj.

- Në lidhje me vendimin për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor, që mban datën 12.8.2014, është përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Korçë. Me këtë akt,

subjekti, si prokuror i çështjes, është njohur në datën 21.8.2014, pas dërgimit nga Komisariati i Policisë Korçë të këtij materiali kallëzues ardhur në Prokurori në datën 20.8.2014.

165. Subjekti shpjegon se mangësitë e konstatuara në vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor, datë 12.8.2014, duke mos shënuar emrin e ekspertit dhe duke mos shënuar datën dhe orën kur do të kryhej ekspertiza, janë gabime të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Korçë. Megjithatë, për të saktësuar situatën faktike, në institucionin e mjekësisë ligjore në vitin 2014 ka qenë vetëm një ekspert mjeko-ligjor, i cili ka bërë edhe shënimin në fund të vendimit për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor.

- Për sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se si prokuror i çështjes nuk ka lidhje me mangësitë që ka pasur materiali kallëzues në veprimet procedurale të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Korçë, në datën 12.8.2014, dhe sjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në datën 20.8.2014 (sipas shkresës nr. *** prot., datë 20.8.2014).

- Subjekti në vijim ka shpjeguar se në gjendjen që ishin aktet dhe në pamundësi objektive për të administruar aktekspertimin mjeko-ligjor, pasi e dëmtuara Xh. Xh. nuk është paraqitur para mjekut ligjor, si prokuror i çështjes ka vendosur mosfillimin, në bazë të germës “c”, të nenit 290, të Kodit të Procedurës Penale. Në mbështetje të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale ky vendim i është komunikuar si të dëmtuarës, ashtu edhe Komisarariatit të Policisë Korçë, sipas shkresave përcjellëse që ndodhen në dosje.

- Në lidhje me komunikimin në telefon që prokurori i çështjes/subjekti ka pasur me të dëmtuarën Xh.Xh pavarësisht se nuk ka një akt të provojë këtë komunikim, krijohet bindja që është bërë ky komunikim pasi në kallëzim shtetasja Xh. Xh., ka të shënuar numrin e telefonit ***, dhe ky komunikim është bërë me numrin të subjektit. Nga ana tjetër vendimi i mosfillimit është dërguar tek kallëzuesja shtetasja Xh. Xh., dhe kjo kallëzuese pasi është njohur me këtë vendim nuk ka bërë kundërshtime apo ankim kundër vendimit. Pra është një rrethanë tjetër që provon këtë komunikim telefonik ndërmjet kallëzueses dhe subjektit në cilësinë e subjektit të rivlerësimit.

- Subjekti ka pranuar se në vendimin e mosfillimit nuk ka analizuar të katërt elementet e kundërvajtjes penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, pasi duke qenë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal e ka konsideruar si të panevojshme dhe pa rëndësi për rastin në shqyrtim.

166. Pas shpjegimeve të subjektit në lidhje me veprimtarinë hetimore të kryer nga prej tij, provohet se subjekti ka vepruar në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

167. Dokument ligjor - vendim “Për pushimin e çështjes”, datë 14.10.2014, përpiluar nga prokurori Edmond Shytko, i takon procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 15.7.2014, për veprën penale “prerje e paligjshme e pyjeve”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për Korçë, ndaj shtetasit H. B.

Konstatime të Komisionit

168. Nga analizimi i akteve, Komisioni konstatoi se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk i është përmbajtur urdhrin të tij për kryerjen e veprimeve hetimore, përkatësisht për marrjen në pyetje të policisë pyjore.

- Deklarata e shtetasit H. B., si person nën hetim, nuk është administruar në dosjen hetimore. Në dosje rezultoi vetëm një dokument, por në të referohet se shtetasi H. B. dëshiron të përgjigjet para një avokati mbrojtës.

- Nga aktet e dosjes nuk rezultoi se shtetasi H. B. dispononte leje apo dokument ligjor për të justifikuar prerjen.

Neni 38 i ligjit “Për pyjet” parashikon se kur shkeljet e listuara nuk përbëjnë vepr penale hyjnë në kategorinë e kundërvajtjes dhe dënohen me gjobë. Çështja e gjobave është detyrë e inspektorëve të policisë pyjore. Kështu, p.sh. prerja e pyjeve ose dëmtimi i tyre, kur pasojat materiale janë të buta, dënohet me gjobë 80.000 lekë – 100.000 lekë. Subjekti i vlerësimit nuk shpjegon dhe nuk e mbështet vendimin e tij në asnjë arsyetim ligjor se dëmi prej 210.000 lekësh përbën kundërvajtje administrative, sipas nenit 38.

Prokurori i çështjes, gjithashtu, duhet të kishte hetuar nëse drunjte e prerë ishin në atë sasi sa të ishte e mjaftueshme për tregti dhe përfitime personale.

Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kërkua të japë shpjegime dhe të depozitonte dokumentacion përkatës lidhur me veprimtarinë procedurale të ndjekur prej tij në dosjen objekt procedimi.

Vlerësimi i Komisionit

169. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka dhënë sqarime të hollësishme në lidhje me veprimtarinë hetimore të kryer nga prej tij, nëpërmjet së cilit provohet se subjekti ka vepruar në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

ANALIZA E GJETJEVE

170. Referuar raportit hartuar nga KLP-ja ka rezultuar se subjekti është vlerësuar pozitivisht në lidhje me:

- a. aftësitë profesionale/njohuritë dhe arsyetimin ligjor;
- b. aftësitë organizative të treguar gjatë ushtrimit të detyrës;
- c. aftësitë personale dhe angazhimi profesional;
- d. për sa i përket etikës në punë dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se veprimtaria e tij ka qenë në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

171. Në lidhje me etikën në punë, Komisioni ka evidentuar elemente në veprimtarinë e subjektit të cilat cenojnë etikën e magistratit në përmbushjen e detyrave të tij, si vijon:

172. Punësimi i subjektit të rivlerësimit në SHBA, për periudhën 2008 – 2016

173. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar të ardhura nga punësimi në SHBA për periudhën 2008 – 2016 ndërkohë që ka ushtruar detyrën e prokurorit.

174. Në lidhje me dypunësimin e subjektit, dhe përkatësisht punën e kryer në SHBA, Komisioni ka kryer vlerësimin bazuar në: (i) nenin 149/ç të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; (ii) nenin 39 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizuar me ligjin nr. 96/2016; (iii) nenin 12 të urdhrin nr. 141, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Mbi miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e

prokurorëve”; (iv) nenin 9 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Nga analiza e dispozitave të mësipërme rezulton se deri në vitin 2016 nuk lejohej dypunësimi për prokurorët, ndërsa me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016 duket se magjistrati ka të drejtë të shkruajë, të publikojë, të japë leksione dhe mësimdhënie për çështjet ligjore dhe të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me çështje ligjore, sistemin ligjor, administrimin e drejtësisë dhe çështje të tjera të lidhura me to edhe jashtë orarit të punës, por nuk mund të kryejë punë tjetër si i dypunësuar.

175. Për sa më sipër, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi punësimi i subjektit në SHBA është në papajtueshmëri me detyrën e prokurorit.

Qëndrimi i subjektit

176. Subjekti ka pretenduar se referuar legjislacionit shqiptar në fuqi, pengesa për dypunësim për magjistratët vlen vetëm brenda vendit dhe jo jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

- Subjekti ka shpjeguar se funksioni i tij si prokuror ka fuqi brenda Republikës së Shqipërisë dhe jo jashtë kufijve të saj, pasi një prokuror brenda Republikës së Shqipërisë është një njeri i thjeshtë jashtë saj.

- Subjekti ka shpjeguar se së bashku me familjen është rezident në SHBA që nga dhjetori i vitit 2004 dhe ndaj këtij shteti, ashtu edhe ndaj Republikës së Shqipërisë, ka të drejta dhe detyrime, pasi në një të ardhshme pretendon të bëhet shtetas amerikan dhe një nga detyrimet në këtë vend është pagimi i taksave, sigurimeve shoqërore dhe detyrime të tjera.

- Në përfundim, subjekti shpjegon se vetëpunësimi në SHBA është bërë kur ka qenë me leje të zakonshme, pra ka pretenduar se ka qenë me pushime dhe nuk ka sjellë pasoja në punën e tij si prokuror në Republikën e Shqipërisë. Në çdo rast kur ka shkuar në SHBA është pajisur me leje nga eprorët, ku ka cilësuar se kërkon lejen e zakonshme.

- Në vijim, subjekti shpjegon se udhëtimet e tij në SHBA nuk janë bërë kurrë pengesë në përmbushjen e detyrave të tij si prokuror, në zvarritjen e hetimeve apo pasoja të tjera negative për çështjet që hetoheshin prej tij.

Vlerësimi i Komisionit

177. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se ato nuk janë bindëse. Subjekti i rivlerësimit, ndërkohë që kryen detyrën e prokurorit në Shqipëri, punësohet edhe në SHBA. Ky veprim i subjektit të rivlerësimit vjen në kundërshtim me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, parashikuar nga pika 1 e nenit 4, të ligjit nr. 96/2016. Gjithashtu, ky veprim i subjektit të rivlerësimit bie ndesh edhe me “Rregullat e etikës dhe sjelljes së prokurorëve”, të cilat, në pikën 5 të nenit 10 parashikojnë se prokurorët duhet të respektojnë ligjet dhe t’u binden në çdo kohë akteve të organeve ligjzbatuese.

178. Në përfundim, Komisioni vlerëson se dypunësimi i subjektit jo vetëm që është në papajtueshmëri me detyrën e prokurorit, por është sjellje joprofesionale dhe joetike nga ana e subjektit të rivlerësimit.

179. Gjithashtu, nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit ka blerë një automjet tip “Audi *” nga shtetasi K. H., i cili, referuar informacionit të marrë nga Prokuroria e

Rrethit Gjyqësor Korçë⁴⁰, në kohën e blerjes së automjetit ka qenë person nën hetim, pasi në këtë prokurori ishte regjistruar procedimi penal nr. *** i vitit 2012, ndjekur në gjykim nga prokurori E.S, për veprën penale të parashikuar nga neni 248-25 i Kodit Penal. Ky shtetas u dënua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me 2 vjet burg. Me vendimin nr. **, datë 13.2.2015, të Gjykatës së Apelit Korçë, është vendosur pushimi i çështjes.

180. Komisioni konstatoi se blerja e automjetit nga një person i cili ishte duke u hetuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, ku ushtronte detyrën e prokurorit subjekti i rivlerësimit, është një veprim në shkelje të etikës si prokuror.

✓ Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës.

Qëndrimi i subjektit

181. Subjekti ka pretenduar se nuk ka pasur dijeni që shtetasi K. S. ka qenë person nën hetim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

182. Komisioni në konstatimin e tij shprehet se subjekti i rivlerësimit duhet të ketë qenë në dijeni, pra nuk është kategorik. Ekzistenca e dyshimit se subjekti i rivlerësimit duhet të ketë qenë në dijeni se shtetasi K. S. ka qenë person nën hetim mbështetet vetëm në blerjen nga bashkëshortja e automjetit tip “Audi A*”.

- Subjekti ka shpjeguar se organi i prokurorisë është një organ i centralizuar dhe mundësia e njohjes me dosjet e një prokurori tjetër ka qenë dhe është e pamundur.

- Prokurori i dosjes E.S e ka dërguar në gjyq të pandehurin K. S., për veprën penale, sipas nenit 248-25 të Kodit Penal. Ky fakt është një provë që provon se subjekti si prokuror nuk ka pasur dijeni që shtetasi K. H. ishte në ndjekje penale, pasi në të kundërt nuk do ta lejonte bashkëshorten ta blinte këtë automjet.

- Edhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që ka bërë dënimin e shtetasit K. H., për veprën penale të parashikuar nga neni 248-25 të Kodit Penal, është përsëri një provë bindëse për padijeninë e subjektit në lidhje me këtë fakt.

Vlerësimi i Komisionit

183. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, për shkak të funksionit të tij, duhet të tregonte kujdes të shtuar në veprimet e tij, për të mos cenuar figurën dhe etikën si magjistrat. Fakti që bashkëshortja e subjektit ka blerë automjetin nga një person i cili ishte nën hetim për “shpërdorim detyre”, në Prokurorinë ku subjekti ushtronte detyrën, është sjellje joetike nga ana e subjektit, i cili nuk ka kryer asnjë veprim për të ruajtur të pacenuar figurën e magjistratit.

DENONCIME

184. Për subjektin e rivlerësimit Edmond Shytko janë administruar 7 denoncime nga publiku. Subjektit iu kërkuan shpjegime për dy çështje, si vijon:

185. Denoncim nr. * prot., datë 26.11.2019, i shtetasit A.B**

Në denoncimin e tij, ky shtetas ka pretenduar se 4 prokurorë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, ndërmjet të cilëve edhe subjekti Edmond Shytko, kanë treguar njëanshmëri në veprimet e

⁴⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2022.

tyre si prokurorë të çështjes penale nr. ***, datë 2.3.2018, të regjistruar për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, me pasojë vdekjen e shtetasit B.B (i biri i denoncuesit).

Denoncuesi jep detaje mbi rrethanat e ndodhjes së aksidentit në të cilin djali i tij humbi jetën. Ky aksident ka ndodhur në datën 30.5.2017, rreth orës 17:15, në segmentin rrugor Korçë - Ersekë, ku automjeti me të cilin po udhëtonte djali i tij u përplas me automjetin e një shtetasi francez, të dy punonjës të shoqërisë “***”.

Nga verifikimi i akteve të depozituara nga denoncuesi, Komisioni ka konstatuar:

- Mospërputhje të orës së aksidentit në akte procedurale të ndryshme.
- Moskryerjen e veprimeve hetimore në përputhje me nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

i. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se ka ndodhur ndryshim i orës së saktë kur ka ndodhur aksidenti, subjekti ka shpjeguar se procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes, si veprim procedural i papërsëritshëm, ka përcaktuar orën 18:00 të datës 3.5.2017 si moment të aksidentit. Procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes është mbajtur nga grupi hetimor dhe i përket kallëzimit penal nr. ***, regjistruar në maj të vitit 2017, hetuar nga prokurori K.H, i cili në datën 9.6.2017 ka vendosur mosfillimin e kallëzimit penal.

Në vijim, subjekti ka shpjeguar se në regjistrimin e çështjes penale nr. ***, datë 2.3.2018, të kryer prej tij si prokurori i ri i çështjes, është vendosur ora 18:30. Vendosja e orës në urdhrin për regjistrimin e procedimit penal është mbështetur në informacionin për referimin e veprës penale dhe është konstatuar se kemi një gabim në orë prej 30 minutash. Ky gabim material është korrigjuar nga subjekti Edmond Shytko në të gjitha aktet e tjera të procedimit penal nr. *** të vitit 2018, midis tyre edhe në kërkesa për pushimin e çështjes, duke vendosur orën 18:00, pra orën e vendosur nga grupi hetimor në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, si akt procedural i papërsëritshëm.

Subjekti shpjegon se ora 18:00, e fiksuar në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, është ora e ndodhjes së aksidentit. Subjekti ka shpjeguar se pasaktësia e orës 18:30, e shënuar në urdhrë regjistrimi të procedimit penal, nuk ka ndonjë rëndësi në proces, përderisa është rregulluar gjatë hetimit deri në kërkesën drejtuar gjykatës për pushimin e çështjes.

Subjekti sqaron se pas regjistrimit të çështjes penale nr. ***, datë 2.3.2013, ka kryer hetimet përkatëse dhe në përfundim të hetimeve, mbështetur në prova dhe brenda afatit ligjor, i ka kërkuar gjykatës pushimin e çështjes. Prova kryesore ku subjekti është mbështetur është aktekspertimi auto-teknik i kryer nga ekspertë në fushën përkatëse, të cilët kanë dalë në përfundimin se shkaktari i aksidentit ka qenë shtetasi B.B, drejtuesi i automjetit dhe njëkohësisht personi që ka vdekur/viktima.

ii. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se subjekti nuk ka kryer veprimet hetimore në përputhje me nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale, mbështetur në vendimin gjyqësor nr. ***, datë 29.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i marrë nga gjykata për kthimin e akteve prokurorisë dhe vazhdimin e hetimeve, e cila ka kërkuar të legjitimojë trashëgimtarët e viktimës,

subjekti ka shpjeguar se gjatë seancës gjyqësore ka mbajtur qëndrimin si vijon: “Çështja penale nr. *** e vitit 2018 është nisur për veprën penale të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, pa autor konkret.

Duke qenë se vepra penale është regjistruar pa autor konkret, organi i prokurorisë nuk mund të vendoste se kush ishte viktimë dhe kush ishte personi nën hetim në këtë aksident të ndodhur. Në këto kushte, nëse do të bëja një veprim të tillë, pra të regjistroja emër personi nën hetim dhe njëkohësisht të legjitimoja viktimën, mendoj se do të bëja gabim, pasi do të shkelja të drejtat e personave në proces. Të dy personat e përfshirë në aksident kanë qenë drejtues mjetesh, duke u përfshirë në aksident. Pra, legjitimitetin e viktimës në proces dhe personit përgjegjës në aksident e ndante aktekspertimi auto-teknik”.

Subjekti ka shpjeguar se nëse do të legjitimonte si viktimë trashëgimtarët e viktimës B.B në momentin e parë pa u administruar akti auto-teknik, si prokuror do të paragjykonte çështjen, duke konkluduar se fajtor ishte drejtuesi i automjetit me shtetësi të huaj. Kur ka ardhur aktekspertimi auto-teknik i kryer me grup ekspertësh dhe është konstatuar se shkaktar në aksident ka qenë drejtuesi i automjetit (viktimë në aksident), shtetasi B.B, subjekti ka kërkuar në gjykatë pushimin e çështjes.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë nuk ka qenë në një mendim me prokurorinë dhe ka kthyer çështjen për vazhdimin e hetimeve dhe legjitimitetin e trashëgimtarëve të viktimës B.B.

- Nga studimi i çështjes penale nr. *** e vitit 2018 del se ankuesit (trashëgimtarit të viktimës) nuk i ka ardhur asnjë pasojë e pariparueshme, por kanë vazhduar hetimet në bazë të detyrave të lëna nga gjykata.

- Në lidhje me këtë çështje, subjekti ka shpjeguar se ka paraqitur deklaratë për dorëheqje, e cila është pranuar nga Drejtuesi i Prokurorisë. Aktualisht, për këtë çështje hetimet vazhdojnë me një tjetër prokuror.

Vlerësimi i Komisionit

186. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se prej tij nuk janë kryer veprimet hetimore sipas parashikimeve ligjore. Këto mangësi në hetim kanë qenë objekt gjykimi edhe nga gjykata, e cila ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. ***/2018, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe vazhdimin e hetimeve që duhet të përfundojnë brenda 2 muajve nga marrja e këtij vendimi formë të prerë. Sa më sipër, referuar përcaktimeve të nenit 73/2 të ligjit nr. 96/2016, lidhet me aftësitë e prokurorit për të hetuar dhe fakti që hetimi ka vijuar me një tjetër prokuror, nuk mund të jetë me peshë në aspektin profesional.

187. Denoncim nr. * prot., datë 12.9.2019, i shtetasit G.B**

Ky denoncues ka paraqitur pretendime në lidhje me veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit si prokuror i çështjes, për procedimin penal nr. **/2019, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, për veprat penale “vrasje me dashje” dhe “armëmbajtje pa leje...”, ndaj shtetasit O. M.

Nga analizimi i akteve të depozituar nga denoncuesi, Komisioni ka konstatuar se:

i. Nuk evidentohet nëse subjekti kur ka paraqitur kërkesën për gjykim përpara gjykatës të ketë parashtruar ndërmjet të tjerave edhe rrethanat se autori i veprës penale ishte në lirim me kusht/arrest shtëpie për kryerjen e një vepre tjetër penale.

ii. Nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore nuk rezulton të jenë pyetur dëshmitarët nëse autori i veprës ka vepruar vetëm apo i shoqëruar, si dhe të qartësonin këtë fakt. Nga sa administrohet, nuk del e qartë nëse subjekti i rivlerësimit ka hetuar në lidhje me kryerjen e veprës penale nga autori në bashkëpunim me një shtetas tjetër.

Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kërkuan të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit

188. Subjekti ka pretenduar⁴¹ se në këtë çështje ka hetuar drejt, me profesionalizëm dhe pa njëanshmëri. Subjekti argumenton se në dosjen nr. **, datë 17.1.2019, është vendosur dëshmia e penaltetit të të pandehurit O.M, e cila përcakton në mënyrë të detajuar dënimet e të pandehurit.

Parashtrimi nga prokurori se i pandehuri O.M ka qenë i dënuar, duke bashkëlidhur dëshminë e penaltetit të të pandehurit, tregon në detaje dënimet e mëparshme të të pandehurit. Gjithashtu, vendimi gjyqësor nr. ***, datë 30.11.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, vërteton faktin se për të dënuarin O.M është aplikuar neni 59/a i Kodit Penal, ku pjesa e mbetur e dënimit të dhënë me vendimin nr. ***, datë 2.11.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. **, datë 26.1.2014, të Gjykatës së Apelit Korçë, që ta vuajë me qëndrim në shtëpi për shkak të kushteve shëndetësore që paraqet.

Ky vendim gjykate ka qenë i njohur nga trupi gjykues që gjykoi të pandehurin O.M. Në këto kushte, prokurori, kur është shprehur në kërkesë apo edhe akte të tjera procedurale se i pandehuri O. M ka qenë i dënuar, do të thotë që trupi gjykues apo edhe trashëgimtarët e viktimës dhe i pandehuri njihen me llojet e dënimit të dhënë (sipas dëshmisë së penaltetit), si dhe me shkakun e lirimit të të pandehurit O.M dhe qëndrimin e tij në shtëpi.

- Në lidhje me deklaratimet e dëshmitarëve okularë të ngjarjes, subjekti ka shpjeguar se ata nuk janë pyetur vetëm në momentin e ngjarjes, ashtu siç i pasqyron denoncuesi, por janë pyetur edhe më pas në vazhdim të hetimeve, duke ju marrë deklaratime shtesë. Këta dëshmitarë janë pyetur edhe gjatë gjykimit. Nga hetimi dhe gjykimi del farë qartë se autori i kësaj vepre penale është O.M, i cili e ka kryer vrasjen vetë dhe jo në bashkëpunim.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato justifikojnë veprimet e tij, për rrjedhojë, nuk mund të klasifikohen si mangësi profesionale.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Në përfundim, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pas propozimit të relatores, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të gërmës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016 dhe për këtë shkak konsiderohet “i aftë”.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat e administruara nga

⁴¹Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti ka depozituar: kërkesën për gjykim; vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; vendimin e Gjykatës së Apelit Korçë; njoftimin për përfundimin e hetimeve; shkresën përcjellëse; dëshminë e penaltetit që i përket shtetasit O.M; si dhe vendimin gjyqësor nr. ***, datë 30.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Komisioni për vlerësimin e kriterit të pasurisë, në shpjegimet e subjektit në seancat dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit Edmond Shytko:

- i. Nuk ka arritur të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, referuar parashikimit të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Edmond Shytko, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 28.9.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI

Kryesuese

Suela ZHEGU

Relatore

Firdes SHULI

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Dajana Skura